

RAPORTI VJETOR

2021

Shoqëria e Sigurimit



ALBSIG



PJESË E
KASTRATI GROUP

www.albsig.al

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Informacioni Rreth Shoqërisë	3
1.1. Misioni, Vizioni dhe Filozofia e Shoqërisë	4
1.2. Profili i Shoqërisë	5
1.3. Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm	6
1.4. Struktura Qeverisë	7
1.5. Veprimtaria në Sigurim e Shoqërisë	8
1.6. Qëllimi i Raportit Vjetor të Shoqërisë	10
1.7. Katër Prioritetet Strategjike të Shoqërisë Albsig sh.a.	12
1.8. Performanca Financiare e Albsig sh.a.	13
2. Qasja Covid-19 dhe Ndryshimet në Industrinë e Sigurimeve	14
2.1. Hyrje	14
2.2. Qasja Covid-19 dhe Ndryshimet në Industrinë e Sigurimeve	15
2.3. Qasja e Menaxhimit të Riskut në Modelet e Punës	15
2.4. Zhvillimet e Sotme dhe Ndikimi në Tregun e Sigurimeve	16
2.5. Ekosistemet dhe Siguruesit	17
2.5.1. Pse Ekosistemet Kanë Marrë një Vëmendje të Re për Siguruesit?	17
2.6. Sigurimi dhe Sfida e Marrjes në Sigurim	19
2.7. Një Qasje e Riskut Strategjik në Procesin e Marrjes në Sigurim	21
2.8. Roli i Qeverisjes së Shoqërisë të Sigurimeve	22
2.9. Përshtatja me Pagesën Sipas Dëshirës	22
3. Zhvillimet Kryesore të Aktivitetit të Shoqërisë Albsig sh.a. Gjatë Vitit 2021	24
3.1. Veprimtaria të Shoqërisë Albsig sh.a.	25
3.1.1. Analiza Vjetore e Shoqërisë Albsig sh.a. 2021-2022	25
3.1.2. Albsig, Organizon Festën e Funvitit	25
3.2. Përgjegjësia Sociale e Shoqërisë Albsig sh.a.	26
3.2.1. Albsig, Kontribues për Mjedis të Pastër, Mbjellja e Pemëve në Tiranë	26
3.2.2. Albsig, në Ndihmë të Fëmijëve me Aftësi Ndryshe	27
3.2.3. Albsig, Mbështet Edicionin e 12-të Shkodra Jazz Festival	29
3.2.4. Albsig, Mbështet Fëmijët e Policëve të Rënë në Krye të Detyrës	30
3.2.5. Albsig, Mbështet Studentët Ekselent të Qytetit të Bulqizës	31
4. Politikat e Monitorimit, Administrimit dhe Kontrollit të Riskut të Shoqërisë	32
4.1. Hyrje	32
4.2. Përgjegjësitë në Kuadrin e Menaxhimit të Riskut	33
4.3. Menaxhimi i Riskut dhe ORSA	33
4.4. Menaxhimi i Riskut dhe Politikat e Pajtuëshmërisë	34
4.5. Përbushja e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut	34
4.5.1. Identifikimi dhe Kategorizimi i Risqeve	35
4.5.2. Vlerësimi i Risqeve	35
4.6. Kornizimi i Riskut i Shoqërisë Albsig sh.a.	36
4.6.1. Risku i Kreditit	36
4.6.2. Risku i Tregut	37
4.6.3. Risku i Normës së Interesit	37
4.6.4. Risku nga Kurset e Këmbimit	38
4.6.5. Risku Operacional	38
4.6.6. Risku Ligjor dhe Rregullator	39

TABELA E PËRMBAJTJES

4.6.7. Risku Strategjik	39
4.6.8. Risku i Risigurimit	39
4.7. Aktive në Mbulim të Provigjoneve Teknike	40
4.8. Marzhi i Aftësisë Pagueuse	42
5. Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm për Vitin 2021	47
5.1. Objektivi dhe Qëllimi i Auditimit të Brendshëm	47
5.2. Metodologjia dhe Parimet e Auditimit të Brendshëm	47
5.3. Pohimi për Pavarësinë	47
5.4. Struktura Organizative dhe Raportimi	48
5.5. Opinioni i Auditorit të Brendshëm	48
6. Raporti i Audituesit të Pavarur	49
6.1. Opinioni i Auditorit të Brendshëm	49
6.2. Pasqyra Individuale e Pozicionit Financiar	52
6.3. Pasqyra Individuale e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	53
6.4. Pasqyra Individuale e Ndryshimeve në Kapital	54
6.5. Pasqyra Individuale e Flukseve Monetare	55
6.6. Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare Individuale	56
7. Objektivat Strategjike dhe Vjetore	61
8. Tendencat e Riskut në Vitin 2022	63
8.1. Sistemi i Inteligjencës së Riskut	63
8.2. Përfitimi i Konsumatorëve nga Shërbimi në Sigurim	64
8.3. Shërbimi në Sigurim Win-Win	65
8.4. Krizat dhe Mundësitë që Ofrojnë në Një Mjedis të Ri	65
8.5. Raporti i Riskut 2022 ¹	67

Lista e Figurave

Figura 1: Ekosistemet e sigurimeve dhe marrëdhëniet e ndërthurura ²	16
Figura 2: Shembuj të krijimit të ekosistemeve në sigurime ³	18
Figura 3: Perceptimi i risqeve global për vitin 2021-2022	66
Figura 4: Përshkrimet e rreziqeve globale 2022	68

Lista e Tabelave

Tabela 1: Kërkesat dhe udhëzimet lidhur me riskun	34
Tabela 2: Faktorët dhe pesha specifike në vlerësimin e riskut	35
Tabela 3: Ekspozimi ndaj riskut të kredisë	36
Tabela 4: Primet e risigurimit të çeduar dhe aktivet e risigurimit sipas normës së kuotimit të risiguresit ...	37
Tabela 5: Risku valutor i shoqërisë më 31 Dhjetor 2021 dhe 2020	38
Tabela 6: Aktive në mbulim të provigjoneve teknike	40
Tabela 7: Niveli i kërkuar i aftësisë paguese llogaritur nga Shoqëria si dhe aftësia paguese e saj	43
Tabela 8: Marzhi i aftësisë paguese duke përdorur metodën e kapitalit neto më 31 Dhjetor 2021	44

¹ The Global Risks Report 2022

² Burimi: Instituti i Shërbimeve Financiare PwC

³ PwC, Unpublished Report, FS 2025



1. INFORMACIONI RRETH SHOQËRISË ALBSIG SH.A.

Albsig sh.a. ("Shoqëria") është themeluar në vitin 2004 si një shoqëri sigurimi me vendndodhje në Shqipëri.

Shoqëria është një shoqëri aksionare me kapital të përbashkët, e regjistruar sipas Ligjit Shqiptar nr.7638, dt.19 Nëntor 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë me vendim të Gjykatës së Rrethit të Tiranës, Nr. 28154, datë 9 Janar 2004.

Shoqëria operon sipas një liçense të lëshuar nga Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare ("AMF"), më përpara i njohur si Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve ("AMS"), për tregtimin e policave të përgjithshme të sigurimit sipas rregullave të AMF-së në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Autorizimi për të ndërmarrë aktivitetet e sigurimit të jo-jetës është marrë më datë 19 Qershor 2004, ndërsa liçensa që specifikon klasat e aktiviteteve është lëshuar më datë 10 Shtator 2004 nga AMS.

Aktivitetet kryesore të biznesit përfshijnë dhënien e shërbimeve të sigurimit për mjetet motorike, pasurinë, shëndetin, dhe produkte të tjera të sigurimit jo-jetë. Shoqëria ka 25 degë gjithësej në qytetet: Tiranë, Durrës, Dibër, Sarandë, Shkodër, Fier, Korçë, Elbasan, Vlorë, Lezhë, Kukës, Gjirokastër, Berat, Kavajë, Lushnjë.

Më 31 Dhjetor 2021, Shoqëria ka patur mesatarisht 243 punonjës dhe drejtues (më 31 dhjetor 2020: 234).

Shoqëria Albsig sha ka Provigjione teknike të mbuluara me aktive dhe Aftësi paguese mbi nivelin e kërkuar nga ligji. Pozicioni financiar me 31 Dhjetor 2021 është (1,829,398,041 lekë (15.1 milion euro).

Gjatë vitit 2019 Shoqëria ka themeluar shoqërinë Albsig Jetë sha me aktivitet në Shqipëri për produktet e jetës.

Shoqëria zotëron 100% të aksioneve. Albsig Jetë sha operon sipas licensës nr.13 të lëshuar nga AMF, për të ushtruar veprimtari sigurimi jetë sipas rregullave të AMF-së në territorin e Republikës së Shqipërisë. Autorizimi për të ndërmarrë aktivitetet e sigurimit të jetës është marrë në datë 13 Shtator 2019.



MISIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.



VIZIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.



FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



1.2. Profili i Shoqërisë

Emri i Shoqërisë:

ALBSIG sh.a.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës:

**Z. Shefqet Kastrati
Z. Arben Breshani
Znj. Ilda Muçmataj**

Drejtor i Përgjithshëm:

Z. Muharrem BARDHOCI

Lokalizimi i Zyrave Qëndrore:

**Rr. "Barrikadave", 1001,
No. 10 – Tirana, Albania**

Data e Themelimit:

09/01/2004

Kapitali Themeltar:

879,460,000 lekë

Numri i Punonjësve:

243

Aktiviteti:

**Në cilësinë e siguruesit
të (Jo-Jetës)**

Tel:

**+355 4 22 54 770
+355 4 22 54 764**

Website:

www.albsig.al

Kontakt:

info@albsig.al

1.3. Mesazh i Drejtorit të Përgjithshëm

Të nderuar klientë dhe bashkëpunëtorë,



Jam krenar të ndaj me Ju, Raportin Vjetor për shoqërinë Albsig sh.a. për vitin 2021, në një vit që paraqiti sfida të jashtëzakonshme dhe të papritura.

Albsig ofroi një të ardhme më të guximshme, 2021 nuk ishte sigurisht një vit i lehtë: nga performanca me çështjet e vështira që duhen adresuar për të ndihmuar tregun tonën dhe shoqërinë të ecin përpara. Duke pasë këtë qasje është

përpjekur për të kontribuar në ndërtimin e një tregu të qëndrueshëm dhe elastik që mund të nxisë rritjen dhe inovacionit në vijim. Performanca jonë e fortë financiare në 2021 dhe progresi do të presin që përfitime të mëtejshme do të bëhen më të dukshme dhe të vlefshme gjatë viteve në vazhdim.

Aktualisht po jetojmë një periudhë të një risku të rritur, apo përjetuar për 75 vjet. Ne po jetojmë në kohë sfiduese, por besojmë se kemi burimet, ekspertizën dhe platformën për të nxitur rritjen e qëndrueshme duke ndihmuar shoqëritë dhe komunitetet t'i përgjigjen sfidave.

Me këtë bazë të qëndrueshme, do të vazhdojmë të sigurojmë dhe të përmbushim përgjegjësitë dhe përkushtimin e të gjithë njerëzve tanë dhe do të doja të vlerësoja zellin e tyre për t'iu përgjigjur një pandemie globale dhe tani një periudhë më të qetësuar pandemike.

Si industri, jemi të gatshëm dhe të aftë për të mbështetur bizneset, komunitetet dhe njerëzit në 2022 dhe më tej. Sigurimi ka një rol kritik për të luajtur, duke ofruar produkte dhe shërbime kaq jetike nevojiten për t'iu përgjigjur një problematike më komplekse dhe të kushtueshme të riskut, duke mbajtur asetet që mund të mbështesin reagimin e shoqërisë ndaj të rejave dhe risqeve të shfaqura.

Faleminderit që keni qenë prezent për klientët tanë dhe njëri-tjetrin.

Faleminderit për mbështetjen e vazhdueshme.

*Me respekt,
Muharrem Bardhoci*

QEVERISJA E SHOQËRISË

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

Shoqëria ALBSIG sh.a. është në pronësi:

- Z. Shefqet Kastrati 100 %

KËSHILLI MBIKËQYRËS I SHOQËRISË

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës:

- Z. Shefqet Kastrati – Kryetar
- Z. Arben Breshani – Anëtar
- Znj. Ilda Muçmataj – Anëtare

KOMITETET

- Komiteti i Administrimit të Riskut
- Komiteti i Auditimit të Brendshëm

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

- Z. Muharrem Bardhoci

DEPARTAMENTET / DEGËT

- ALBSIG është i organizuar në 7 Departamente
- ALBSIG ka **26** degë, të vendosura në çdo qytet në Shqipëri
- Numri i të punësuarve është **243**
- Kapitali i paguar i shoqërisë më 31 Dhjetor 2021 është **879,460,000** Lekë
- Kapitali së bashku me fitimin e mbartur me 2021 është **1,829,398,041** (15.1 milion euro)

1.5. Veprimtari Sigurimi Jo-Jetë i Shoqërisë në Klasat e Sigurimit

Licenca i jep të drejtën Shoqërisë së Sigurimeve Albsig sh.a. e kryerjes së operacioneve të sigurimit në cilësinë e operatorit të Jo-Jetës sipas grupeve të sigurimit të listuara më poshtë:

* Grupi nr. 1	"Aksidente"
* Grupi nr. 2	"Sëmundjet"
* Grupi nr. 3	"Mjete tokësore" (të ndryshme nga ato që lëvizin mbi shina)
* Grupi nr. 4	"Mjete lëvizëse mbi shina"
* Grupi nr. 5	"Avionët"
* Grupi nr. 6	"Anijet"
* Grupi nr. 7	"Mallrat në transport"
* Grupi nr. 8	"Zjarri dhe forcat e natyrës"
* Grupi nr. 9	"Dëmtime të tjera të pasurisë"
* Grupi nr. 10	"Përgjegjësitë civile nga përdorimi i automjeteve"
* Grupi nr. 11	"Përgjegjësitë civile nga përdorimi i avionëve"
* Grupi nr. 12	"Përgjegjësitë civile nga përdorimi i anijeve"
* Grupi nr. 13	"Përgjegjësitë civile të përgjithshme"
* Grupi nr. 14	"Sigurimi i kreditit" Licencimin e shoqërisë së sigurimit të Jo-Jetës Albsig sh.a., për zgjerimin e ushtrimit të veprimtarisë në klasën e 14-të të sigurimit, me vendim Nr. 21, datë 27.02.2020.
* Grupi nr. 15	"Garancitë"



Shoqëria Albsig,

**ndihmon për të krijuar
një botë më të guximshme
duke mbrojtur atë që ka më shumë
rëndësi për klientët tanë,
duke i ndihmuar të shërohen
në kohë nevoje dhe në ndërtimin
e një elasticitetit
të ndarjes së riskut.**



Qëllimi i këtij Raporti Vjetor të shoqërisë, është strategjik sepse ofron një pamje gjithëpërfshirëse se si përmbushim qëllimin për të krijuar një botë më të guximshme përmes katër strategjive tona prioritete; **performanca, digjitalizimi, kultura** dhe **qëllimi**.

Qëllimi ynë mbështetet nga një qëllim unifikues: ndarja e riskut për të krijuar një botë më të guximshme.

Prioritetet tona strategjike: do të vazhdojmë të përqëndrohemi në katër prioritetet strategjike, duke dhënë vlerë në një botë që ndryshon me shpejtësi.





Albsig
duke iu referuar situatës së pandemisë
ka rivlerësuar masat e marra
të përshtatura me situatën dhe
aktet normative në fuqi duke qënë
në një koherencë në lidhje me to,
për vazhdimësinë e aktivitetit
në kushtet e pandemisë me anë
të planeve të veprimit dhe është
gjithmonë në rivlerësime periodike
në ndihmë të punonjësve
dhe klientëve të saj.



1. Performanca

Në vitin 2021 Albsig raportoi një kthim të fortë në përfitim, me një fitim të përgjithshëm prej 287 milion para tatimit (2020: prej 193 milion).

Albsig Sh.a. ka provigjone teknike të mbuluara me aktive dhe Aftësi Pagaese mbi nivelin e kërkuar nga ligji. Fokusi ynë në performancën e qëndrueshme dhe fitimprurëse vazhdon dhe për vitin 2022 dhe do të mbështetet nga kuadri mbikëqyrës i bazuar në parime dhe ofrimi i një qasje të diferencuar për planifikimin e biznesit.

2. Digjitalizimi

Kjo strategji është e fokusuar për vendosjen e të dhënave të qarta dhe të sakta nëpërmjet përdorimit të një tregu standard e të gjere të të dhënave.

Duke vepruar kështu, do të ofrojmë efikasitet të prekshëm tregu, duke përfshirë koston e reduktuar dhe kompleksitetin e të bërit biznes.

3. Kultura

Në vitin 2021 vazhduam angazhimin tonë në ndërtimin e një themeli të fortë për të krijuar një kulturë të larmishme, gjithëpërfshirëse dhe me performancë të lartë në të gjithë shoqërinë Albsig sh.a.

4. Qëllimi

Kemi vendosur Mjedisin, Socializimin, Qeverisjen në qendër të gjithçkaje që bëjmë.

Ne synojmë të udhëheqim tregun duke vazhduar zhvillimin e praktikave të qëndrueshme në 2022.

1.8. Performanca Financiare e Albsig sh.a.

PRIMI I SHKRUAR BRUTO

3.3 MILIARDË LEKË

2020:
2.7 MILIARDË LEKË

FITIMI PARA TATIMIT

287 MILION LEKË

2020:
193 MILION LEKË

RAPORTI I KOMBINUAR

89 %

2020:
92%

RAPORTI I HUMBJES

25 %

2020:
34%

RAPORTI I SHPENZIMEVE

64 %

2020:
58%

FITIMI I NËNSHKRUAR

240 MILION LEKË

2020:
160 MILION LEKË

2.1. Hyrje

Institucionet financiare duhet të përshtaten me një botë që ndryshon me shpejtësi e karakterizuar nga risqe të reja dhe në zhvillime të nxitura nga ekspozimet kibernetike lidhur me teknologjinë, një barrë në rritje e pajtueshmërisë dhe problemet e Covid-19. Në të njëjtën kohë, sjellja dhe kultura e institucioneve financiare përfshihet në një gamë të gjerë palësh të interesuara në fusha të tilla si qëndrueshmëria, praktikat e punësimit, diversiteti dhe përfshirja. Sipas Barometrit të Riskut Allianz 2021, në një anketë të zhvilluar me 900 të anketuar problemet më të mëdha të hasura lidhen me: Incidentet kibernetike, shpërthimi i pandemisë dhe ndërprerja e biznesit e ndjekur nga ndryshimet në legjislacion dhe rregullore — të nxitura nga mjedisi, shoqëria dhe qeverisja. Mjedisi COVID-19 po ofron gjithashtu lehtësi për keqdashësit që kërkojnë të shfrytëzojnë krizën pasi pandemia çoi në një rritje të shpejtë dhe kryesisht të paplanifikuar të punës nga shtëpia, tregtisë elektronike dhe digjitalizimit. Pavarësisht shpenzimeve të konsiderueshme të sigurisë kibernetike, kompanitë e shërbimeve financiare janë një objektiv tërheqës dhe përballen me një gamë të gjerë kërcënimesh kibernetike.




2.2. Qasja Covid-19 dhe Ndryshimet në Industrinë e Sigurimeve

Rimëkëmbja ekonomike globale nga recesioni i shkaktuar nga Pandemia e COVID-19 vazhdon por është duke u ngadalësuar. Pas një tkurrjeje prej 3.1% në 2020, rritja ekonomike globale pritet të arrijë 5.9% në 2021 dhe ngadalë në 4.9% në 2022. Deri në vitin 2024, parashikohet që ekonomia globale të jetë 2.3% më e vogël se sa do të ishte pa pandeminë.

Risqet për rritjen ekonomike janë të konsiderueshme, duke përfshirë risqet nga një ringjallje e mundshme e COVID-19 në qasjen e varianteve të ndryshme.

COVID-19 shkaktoi një recesion global, por dallime të mëdha në shkallën e vaksinimit që do të peshojë mbi disponueshmërinë e punëtorëve dhe produktivitetit, prishjen e zinxhirëve të furnizimit dhe dobësimin e konsumatorit.

Edhe pse punësimi po afrohet në nivelet para-pandemike në shumë ekonomi të avancuara, globalisht rimëkëmbja e vendeve të punës nga kriza e COVID-19 po ngec në atë të rimëkëmbjes ekonomike- punësimi global mbetet më i ulët se para pandemisë.



2.3. Menaxhimi i Riskut në Modelet e Punës

Disa punonjës të kualifikuar janë të gatshëm të punojnë për siguruesit duke përdorur një model pune më fleksibël, si p.sh. me kohë të pjesshme ose në bazë të projektit. Duke zhvilluar aftësinë për të shkallëzuar fuqinë dhe talentin e tyre sipas nevojës dhe janë pikërisht këta që përshtaten shumë më shpejt ndaj tregjeve që ndryshojnë me shpejtësi.

2.4. Zhvillimet e Sotme dhe Ndikimi në Tregun e Sigurimeve

Fakti që risku i pajtueshmërisë po rritet është shqetësues, pasi çështjet e pajtueshmërisë janë tashmë prezente në industrinë e sigurimeve. Incidentet kibernetike tashmë rezultojnë në pretendimet më të shtrenjta dhe siguruesit po shohin një numër në rritje të humbjeve të lidhura me teknologjinë, duke përfshirë pretendimet e bëra kundrejt drejtorëve pas shkeljeve së privatësisë.

Industria shpesh kërkon një pamje afatëgjatë duke marrë parasysh risqet, politikat që mund të zgjasin dhe nevojën për të ndërtuar dhe mbajtur njohuri dhe projekte që të kenë rezultate në të ardhmen.

Por tani, ekosistemet e sigurimeve po përmbysin shumë nga këto supozime të mbajtura prej kohësh. Duke zgjedhur qasjen ndaj ekosistemeve, operatorët më të vegjël ose lojtarët rajonalë mund të jenë në gjendje të mbyllin hendekun e mundësive.

Figura 1, me poshtë jep një paraqitje se si krijohen ekosistemet. Historikisht kompanitë ishin mjaft të pavarura. Në të kundërt, ekosistemet përfaqësojnë një grup shumë më të thellë marrëdhëniesh të ndërthurura në një fushë të caktuar, me qeverisje dhe teknologji që u jep vlerë klientëve dhe janë fitime për partnerët. Modeli i ri fillon me vendosjen e nevojave dhe dëshirave të klientëve në radhë të parë

Ai kërkon të krijojë një përvojë të dëshirueshme blerjeje, duke përfshirë produktet dhe shërbimet që dëshirojnë klientët. Për të pasur sukses, kompanitë do të duhet të ripërqëndrohen në pothuajse çdo pjesë të organizatës së tyre.

Termi "ekosistem" i referohet një sistemi të ndërlidhur i ofertave nga një sërë ofruesish pjesëmarrësish, duke i lejuar klientët të përmbushin nevojat e shumëfishta nëpërmjet një përdoruesi të integruar.	Oferta të ndërlidhura	Sigurime që adresojnë një sërë risqesh personale
	Shumëllojshmëri ofruesish	Mund të përfshijnë operatorë të shumtë, kompani InsurTech,
	Konsumatorët përmbushin nevojat të shumta	Shërbime ndihmëse
	Përvoja e integruar e përdoruesit	Qasja me qendër klientin i jep blerësit zgjedhje të gjerë
		Ndërfaqe e konsoliduar, pavarësisht se sa kompani kanë dhënë ofertën.

Figura 1: Ekosistemet e sigurimeve dhe marrëdhëniet e ndërthurura ⁴

⁴ Burimi: Instituti i Shërbimeve Financiare PwC

”EKOSISTEM”

**1 referohet një sistemi të ndërlidhur të ofertave,
nga një sërë ofruesish pjesëmarrësish,
duke i lejuar klientët të përmbushin nevojat e shumëfishta,
nëpërmjet një përdoruesi të integruar.**

2.5.1. Pse Ekosistemet Kanë Marrë një Vëmendje të Re për Siguruesit?

Pandemia ka përshpejtuar evolucionin e ekosistemit. Të gjithë e kemi vënë re këtë. Por gjatë pandemisë, shitja me pakicë dhe klientët komercialë kanë mësuar shpejt të angazhohen nga distanca, dhe tani presin shërbim 24/7 dhe ndërveprime të lehta brenda çdo kërkesë që kanë.

Ky model i shërbimit të ofertës dhe kërkesës ka filluar të duket më i mirë, më i shpejtë dhe më i lirë. Teknologjia e aktivizimit të këtij shërbimi është e përballueshme dhe funksionon, i bazuar në teknologjine e re, dhe nga mësimi i përdorimit të tyre janë ndihmuar firmat InsurTech të rriten shpejt pa peshën e sistemeve tradicionale të përdorura deri tani.

Si pjesë e një sondazhi mbi industrinë e shërbimeve financiare⁵ në vitin 2025, 79% e drejtuesve të sigurimeve që u pyetën ranë dakord “Siguruesit do të angazhohen gjithnjë e më shumë në ekosisteme që shërbejnë gjerësisht për nevojat e klientëve, ku sigurimi është vetëm një pjesë e zinxhirit të vlerës së klientit.”



⁵ PwC, unpublished report, FS 2025

PRONA DHE
FATKEQËSIA
(INDIVIDËT)

PRONA DHE
FATKEQËSIA
(TREGTARE)

JETA DHE
PENSIONI

GRUPET

DALJA NË
PENSION

MAKINAT INTELIGJENTE SMART

Shërbime që lidhen me transportin e njerzve nga pika A në pikën B, përfshirë sigurimi telematik të makinës, shitës makinash, shërbime asistence për makinat, ofruesit e maikanve



MIRËQENIE

Të gjitha shërbimet që lidhen me mirëqenien fizike dhe mendore, duke përfshirë kujdesin për të moshuarit, ofruesit e asistencës, shërbimet mjekësore, palestrat, prodhuesit e veshjeve, markat e veshjeve sportive dhe mësimdhënien në IoT (internet of things)



SHËRBIMET E BIZNESEVE

Shërbimet e biznesit të suportojnë kompanitë e vogla, duke përfshirë kontabilitetin, taksat, dhe listen e pagave, sigurimi i bizneseve, programet e përfitimeve të punonjësve, banking, programet e daljes në pension, ligjori, IT dhe shërbimet e marketingut

Individët
KLIENTËT
Tregëtarët



SIGURIA

Të gjitha shërbimet që lidhen me sigurinë e individëve ose organizatave, duke përfshirë sigurimin e vjedhjes, shërbimet e mbrojtjes së të dhënave, aplikacionet e gjurmimit dhe pajisje të tjera sigurie

PUNA DHE PENSIONI

Të gjitha shërbimet që lidhen me mirëqenien financiare përfshijnë bankat, menaxherët e aseteve, kompanitë e fondeve, ofruesit e shërbimeve të depove, FinTechs dhe reklamuesit robotike



SHTËPIA INTELIGJENTE SMART

Të gjitha shërbimet që lidhen me jetesën në shtëpinë inteligjente përfshinin ofruesit e teknologjive dhe shërbimeve të IoT, shitësit me pakicë të pajisjeve, ofruesit e transmetimit dhe agjentët e pasurive të paluajtshme.

Figura 2. Shembuj të krijimit të ekosistemeve në sigurime ⁶

⁶ PwC, Unpublished Report, FS 2025
Inteligjenca Artificiale

Sfida e siguruesit: Shndërrimi i të dhënave në informacion të dobishëm

Industria e sigurimeve tashmë po e kupton se ka shumë mënyra sesi teknologjia mund të ndihmojë në përmirësimin e vendimeve në lidhje me sigurimin. Ka pasur një ndryshim të mjeteve të përdorëshme më parë, por gjasat kanë ndryshuar duke u mbështetur në teknikat e inteligjencës artificiale (AI) si (ML) për të marrë vendime më shumë "të drejtuara nga të dhënat", kështu që kompanitë kanë shumë për të zgjedhur sot. (AI) mund të jetë jashtëzakonisht i dobishëm si një plotësues për siguruesit e aftë dhe automatizimin inteligjent që mund të çlirojë stafin ku fuqia e trurit përdoret për të shtuar vlerë në vend që thjesht të merret me punë rutinore ditore.

AI

**mund të jetë jashtëzakonisht i dobishëm si një plotësues
për siguruesit e aftë dhe automatizimin inteligjent
që mund të çlirojë stafin ku fuqia e trurit përdoret
për të shtuar vlerë në vend që thjesht të merret
me punë rutinore ditore.**

Sot kemi projekte dhe zhvillime të marrjes në sigurimin digjital të bazuar në modelin e AI (inteligjencës artificiale). Qasja e pandemisë ka bërë që disa sigurues të mendojnë se ku t'i zbatojnë këto përpjekje për efekt maksimalizimi. Pas krizës financiare të fundit të viteve 2000, shumica e siguruesve u përqëndruan për forcimin e bilanceve të tyre. Ndërsa kthimet nga investimet u rritën dhe humbjet e pritshme nuk arritën të materializoheshin, kompanitë ishin në gjendje për të gjeneruar fitime tërheqëse.

Siguruesit u inkurajuan të përqëndroheshin në sjelljen e biznesit. Por tashmë po shihet së kjo kohë ka përfunduar. Por ajo që nevojitet së pari në adresimin e sfidave është lidhja e vendimeve të marrjes në sigurim me përvojën e humbjes së të dhënave në një bazë të dhënash për një shtrirje të gjerë kohore. Kjo bën të mundur që të zgjedhim risqet në mënyrë më efektive, duke përmirësuar përvojën e klientit dhe duke e realizuar si proces me një kosto më të ulët.

Cikli i marrjes në sigurim ka ndryshuar, marrja në sigurim është një problem i vazhdueshëm matematikor: simulimi i humbjeve të pritshme, segmentimi i klientëve sipas sjelljes, duke vlerësuar se sa përqind e riskut duhet t'u jepet risiguruesve, etj. Por është e kuptueshme se vlerësimi i një risku të caktuar ishte ndryshe në vitin 2011 dhe ka qasje tjetër në vitin 2021, dhe analitika është vetëm një pjesë e historisë. Drejtuesit e sigurimeve e kuptojnë se tani kemi një nga tregjet më të vështira në dekada.

Mësimi i ML⁸ varet nga të pasurit e një grupi të dhënash që mund të ndihmojnë për të kuptuar së si bota funksionon, por nuk kemi parë një treg të tillë më parë. Zinxhiri i furnizimit të informacionit është prishur. Një nga zhvillimet më intriguese dhe frustruese për marrjen në sigurim ka të bëjë me vazhdimësinë e të dhënave. Praktikuesit e dinë këtë dhe mund të marrin vendime më të mira nëse do të kishin akses në kohë në burimet e duhura të të dhënave.

MACHINE LEARNING

përcakton një grupi të dhënash që mund të ndihmojnë

për të kuptuar së si bota funksionon,

por nuk kemi parë një treg të tillë më parë.

Zinxhiri i furnizimit të informacionit është prishur.

Një nga zhvillimet më intriguese dhe frustruese

për marrjen në sigurim ka të bëjë me

vazhdimësinë e të dhënave.

Praktikuesit e dinë këtë dhe mund të marrin vendime më të mira

nëse do të kishin akses në kohë në burimet e duhura të të dhënave.



Analiza është thelbësore kur përfaqësuesit e shitjeve, agentët ose ndërmjetësit veprojnë me klientët. Përfaqësuesit e shitjeve duhet të shkojnë në takime të përgatitur me mundësi specifike shitjeje, duke përfshirë të dhëna për të treguar si dhe ku ekzistojnë mundësitë dhe ide të zbatueshme se si t'i ndjekin ato. Përfaqësuesit duhet të jenë në gjendje të ndihmojnë ndërmjetësit të identifikojnë boshllëqet në treg për t'i shfrytëzuar. Drejtuesit duhet të përgatiten me përfaqësuesit e tyre me të dhëna në mënyrë që të kenë më shumë njohuri se si të drejtojnë biznesin, dhe përse oferta e produktit të tyre do të rezonojë me blerësit e ndërmjetësit. Në fakt, siguruesit tani kanë filluar të përballojnë të dhëna nga burime që ishin të paimagjinueshme jo shumë kohë më parë. Siguruesit tashmë kanë dëgjuar mjaftueshëm për mënyrën se si duhet të marrin më shumë vendime "të orientuara nga të dhënat" dhe, në të vërtetë, marrja në sigurim duket së ka të dhëna. Por shpesh vjen në formën e raporteve statistikore mujore ose tremujore.

2.7. Një Qasje e Riskut Strategjik në Procesin e Marrjes në Sigurim

Kjo bën të mundur që dinamika e ciklit për marrjen në sigurim të funksionojë. Në teori, përfitimi nuk duhet të jetë ciklik, pasi ngjarjet e humbjes janë të rastësishme. Shumica e kompanive vazhdojnë të ndjekin tendencat e gjera, duke kërkuar të maksimizojnë fitimet ose të minimizojnë humbjet.

Kuptohet se çmimi konkurrues është një strategji e rëndësishme dhe se shumë blerës sigurimesh janë të nxitur nga kostoja. Për të vlerësuar në mënyrë më të plotë, do të fillonim me një pamje më strategjike të risqeve perfshirëse. Siguruesve u duhet dhënë informacioni i duhur në kohën e duhur.



Në vitin 2021 shohim më shumë sigurues që lëvizin për të riimagjinuar rolin e marrjes në sigurim duke u dhënë atyre fuqinë për të kthyer të dhënat e papërpunuara në inteligjencë.

Kjo mund të bëhet me sisteme inteligjente të dhënash që u japin siguruesve informacion në kohë reale për atë që ka ndryshuar në mënyrë që të mund të zbatojnë gjykimin dhe përvojën e tyre. Shume pyetje lindin dhe kërkojnë përgjigje për t'u kuptuar dhe reagimi ndaj fenomeneve të reja që po hasim.

2.8. Roli i Qeverisjes së Shoqërisë së Sigurimeve

Referuar kërkimeve të fundit siguruesit që kanë një avantazh të qëndrueshëm në marrjen në sigurim në mënyrë rutinore i tejkalojnë shoqëritë e tjera. Strategjia e marrjes në sigurim dhe qasja e Matjes së Performancës së Sigurimeve, tregon që siguruesit kryesorë ndajnë katër tipare kryesore:

- Zgjedhja e riskut strategjik
- Efikasiteti operacional
- Menaxhimi i disiplinuar i shpenzimeve
- Portofole të larmishme

Por kur situata bëhet e vështirë, qeverisja e tregut zakonisht mban kontrolle shtrënguese. Kjo nënkupton menaxhimin e riskut të përgjithshëm të portofolit kundrejt metrikave të përcaktuara qartë, duke përdorur linjat e produktit dhe kontrollet e njësive të biznesit për të tejkaluar riskun e përzgjedhjes dhe të çmimit.

Kjo është arsyeja pse është kaq e rëndësishme që të thjeshtohet zinxhiri i furnizimit të informacionit. Çështjet kryesore të industrisë së sigurimeve në 2021 treguan se siguri gjithmonë është mbështetur në ekspertizën njerëzore dhe ndoshta gjithmonë kështu do të jetë, veçanërisht për risqe më të mëdha, e më komplekse. Një kombinim i pamundur i pretendimeve në rritje dhe rritjes së konkurrencës po i shtyn shoqëritë të hedhin një vështrim të ri se si mund të bëhet marrja në sigurim më shpejt dhe më produktiv.

2.9. Përshtatja me Pagesën Sipas Dëshirës

Shumica e produkteve të sigurimit të sotëm janë të ngjashëm me ato të një brezi më parë. Procesi i marrjes në sigurim ka parime të ngjashme dhe funksionon përmes të njëjtëve agjentë dhe ndërmjetës. Por kjo periudhë statike mund të marrë fund, e udhëhequr nga rritja e sigurimeve të bazuara në përdorim

**Politikat "Pay-as-you-go" janë ende produkte të veçanta,
por ato kanë tërhequr më shumë vëmendje gjatë pandemisë.**

Kur njerëzit shohin makinat e tyre të pashfrytëzuara për muaj të tërë, shumë pyesin veten pse po paguajnë për sigurimin e tyre kur nuk janë duke e përdorur. Qiramarrësit komercialë ndjehen në të njëjtën situatë pasi paguajnë për të siguruar hapësirën e papërdorur të zyrës. Kompanitë e tjera u është dashur të rregullojnë manualisht mbulimin e kompensimit të punonjësve për të pasqyruar pushimet nga puna. Ka një rritje të ndjeshmërisë për të përafëruar primet e sigurimit me vlerën e tyre të perceptuar.

Në muajt e parë të pandemisë, u pa që disa kompani jepnin zbritje të përkohshme ose rimbursime të bazuara në ekspozimet e reduktuara të riskut – ndonjëherë me urdhër të rregullatorëve. Shumica e përdoruesve të automjeteve personale tani kanë prezantuar një lloj programi UBI/BBI ⁹,

Përdorimi i të dhënave telematike në një strategji efektive UBI mund të ndihmojë të vlerësoni dhe reduktoni riskun duke krijuar mundësinë për ndërveprime me klientët. Zgjidhjet moderne të UBI, gjithashtu u mundësojnë siguruesve të operacionalizojnë programet UBI dhe të përdorin në mënyrë optimale të dhënat telematike.

Për shembull, drejtuesit e sigurimeve mund t'i vlerësojnë produktet në varësi të mënyrës, kur dhe ku ngasin klientët e tyre. Kjo i ndihmon ata të kuptojnë dhe llogarisin primin në mënyrë shumë më efikase dhe të saktë (dhe të arrijnë shumë përfitime të tjera të biznesit).

Ndërsa shumë analistë të industrisë kanë parashikuar prej kohësh se programet e sigurimit të bazuar në përdorim (UBI) dhe të sigurimit të bazuar në sjellje (BBI) do të revolucionarizojnë të gjithë industrinë e sigurimeve të automobilave, është e qartë se këto tendenca do të zhvillohen në të ardhmen.

Megjithëse këto prirjen në ofrimin e zbritjeve në vend të rillogaritjes së primeve. Akoma, ka indikacione se qasje të reja po vijnë në industri, dhe ato mund të tërheqin më shpejt blerësit të cilët mund të mendojnë se tashmë po paguajnë për përfitimet që nuk mund të përdoren. Ndërkohë, edhe nëse të ardhurat bien, siguruesit mund të shohin rritjen e rentabilitetit duke përdorur të dhënat në mënyrë më efektive për të vlerësuar ekspozimin e tyre të vërtetë.

Produkte të reja, kërkesa të reja Në sondazhin e CEO 2021, drejtuesit treguan se do t'i drejtohen lancimit të produkteve të reja si një komponent kryesor i rritjes gjatë vitit të ardhshëm. Por lancimi i një produkti sigurimi që është vërtetë i ri është shumë i ndryshëm nga nxjerrja në treg e një smartphone të ri dhe dizanjimi i produkteve të sigurimit që mbajtësit e policave e perceptojnë se janë të vlerësuar me çmime më të drejta mund të jetë veçanërisht i vështirë.

Do të duhet të zhvillojë teknika të reja dhe kompetenca për të përfshirë në mënyra të ndryshme për të vlerësuar, marrjen në sigurim dhe riskun e çmimit.

⁹ Përdorimi i të dhënave telematike në një strategji efektive UBI mund t'ju ndihmojë të vlerësoni dhe reduktoni riskun duke krijuar mundësinë për ndërveprime me klientët. Siç u përmend shkurtimisht më lart, shumë operatorë sigurimesh ofrojnë një tarifë ose çmim të bazuar në telematikë bazuar në një pikë të vetme (që siguruesit mund të mos e kuptojnë ose të kenë mundësi ta ndryshojnë). Ky rezultat do të përcaktojë zbritjen që duhet të ofrojnë siguruesit. Mund të duket e vlefshme, por në një biznes me marzh të ulët, kjo qasje mund të dëmtojë kompaninë e sigurimeve pasi mungesa e kontrollit mund të çojë në zbritje që gërryejnë marzhet e fitimit. Përgjigja është një zgjidhje inovative telematike që ofron shumë më tepër të dhëna sesa thjesht një rezultat të papërcaktuar, të rastësishëm. Zgjidhjet moderne të UBI gjithashtu u mundësojnë siguruesve të operacionalizojnë programet UBI dhe të përdorin në mënyrë optimale të dhënat telematike. Për shembull, drejtuesit e sigurimeve mund t'i çmojnë produktet në varësi të mënyrës, kur dhe ku ngasin klientët e tyre. Kjo i ndihmon ata të kuptojnë dhe llogarisin primin në mënyrë shumë më efikase dhe të saktë (dhe të arrijnë shumë përfitime të tjera të biznesit). Ndërsa shumë analistë të industrisë kanë parashikuar prej kohësh se programet e sigurimit të bazuar në përdorim (UBI) dhe të sigurimit të bazuar në sjellje (BBI) do të revolucionarizojnë të gjithë industrinë e sigurimeve të automobilave, është e qartë se këto tendenca do të zhvillohen në të ardhmen.

3. ZHVILLIMET KRYESORE TË AKTIVITETIT TË SHOQËRISË ALBSIG SH.A. GJATË VITIT 2021

Aktiviteti i shoqërisë për vitin 2021 vlerësohet pozitiv, pavarësisht se ishte vazhdimi i një viti pandemik. Bilanci i shoqërisë rezulton me fitim. Veprimtaria ekonomiko-financiare e vitit 2021 çoi në konsolidimin e mëtjshëm të shoqërisë. Albsig Sh.a. përfaqëson një subjekt të konsoliduar, konform të gjitha standarteve dhe kërkesave të akteve ligjore e nënligjore. Aktiviteti ekonomik përgjatë vitit 2021 ka shënuar progres të ndjeshëm. Është rritur prezenca e Albsig sh.a. në tregun e sigurimeve.

Shoqëria Albsig Sh.a. edhe gjatë vitit 2021 është pozicionuar në vend të dytë në tregun e sigurimeve jo-jetë si rrjedhojë e një pune shumë rezultative në linjat e produkteve vullnetare sidomos të Pronës, Përgjegjësi në vecanti Përgjegjësia e Ndërtuesit, Garancive, në produktin Kasko, Portofoli "Aksidente dhe Shëndet", në vecanti produkti Sigurimi i Aksidenteve.

- Shoqëria, për vitin 2021 përsëri renditet e para në tregun e sigurimeve për produktet Kasko, Përgjegjësia dhe Garancitë, e dyta për sigurimet vullnetare duke patur raportin më të lartë në treg 53.17%.
- Për linjat e detyrueshme motorike, prezenca në treg për vitin 2021 është 13.12% nga 11.88% në 2020.
- Për sigurimet vullnetare, prezenca në treg për vitin 2021 është 29.83% nga 29.55% në vitin 2020 duke u pozicionur në vend të dytë dhe me rritje nga 2020.
- Pavarësisht ndikimit të pandemisë, shoqëria Albsig sh.a. për vitin 2021 ka rritjen më të madhe në treg me 23.81% ndërkohë që tregu i sigurimeve jo-jetë ka rritje me 15.40%.
- Në totalin e të ardhurave nga sigurimet në veprimtarinë e shoqërisë Albsig sh.a. sigurimet vullnetare zënë 53.17% për vitin 2021, ndërsa sigurimet e detyrueshme motorike (TPL, Kartoni Jeshil dhe Sigurimi Kufitar) përbëjnë rreth 46.83% të të ardhurave nga primet.
- Dëmet e paguara janë 873,105 mijë lekë për vitin 2021 nga 1,750,951 mijë lekë dëme të paguara për vitin 2020, pra rreth 50% më pak ose 877,846 mijë lekë më pak duke u renditur në vend të tretë në treg me 14.41% të tregut. Rënia ka ardhur si rrjedhojë se shoqëria Albsig i pagoi dëmet e ngjarjeve të tërmetit 2019 pothuajse gjatë vitit 2020 dhe një pjesë të vogël gjatë vitit 2021.
- Por pjesë e konsiderueshme e dëmeve janë dhe dëmet e paguara për sigurimin motorik me vlerë 511,917 mijë lekë për vitin 2021 nga 586,823 mijë lekë për vitin 2020.
- Dëmet e paguara për Aksidentet dhe Shëndetin janë 87,069 mijë lekë në vitin 2021 nga 66,522 mijë lekë në vitin 2020.

3.1. Veprimatari të Shoqërisë Albsig sh.a.

3.1.1. Analiza Vjetore, Traditë e Përvitshme e Shoqërisë Albsig sh.a.

Puna e këtij fillimviti ka nisur me Analizën Vjetore të Shoqërisë së Sigurimeve Albsig Sh.a. Si çdo fillim viti, stafi menaxhues i shoqërisë Albsig Sh.a. analizon arritjet e vitit të kaluar dhe përcakton detyrat dhe objektivat për vitin në vijim kjo në shërbim të përmirësimit të qasjes ndaj klientit.

Albsig Sh.a. me strategji të qartë kërkon për të qënë sa më e pranishme me të gjithë gamën e produkteve të sigurimeve për të cilat synojmë gjithmonë të jemi një hap përpara dhe në përmirësim të vazhdueshëm e të pandalshëm.

Optimiste ka qënë atmosfera pasi trendi i rritjes së aktivitetit të shoqërisë sa vjen e shtohet, sidomos në produktet vullnetare.

Në analizën e punës e cila është bërë traditë, kanë marrë pjesë drejtues dhe specialist të punësuar në Albsig duke përfshirë këtu gjithë rrjetin e shitjes dhe administrimin.

Krahas punës së mrekullueshme të gjithë stafit të kualifikuar nën drejtimin e Z. Muharrem Bardhoci dhe Bordit Drejtues, që rezultoi me një rritje mjaft të konsiderueshme krahasuar me vitin 2021, u diskutua dhe u morën angazhime për të vazhduar punën me përkushtim në shërbim të klientit.

U vendosën strategjitë e punës si prioritetet, avantazhet dhe objektivat për vitin 2022.

Këto kanë qënë dhe cështjet më të përfolura për planin e punës për vitin 2022.

Shoqëria Albsig sha është tashmë me trendin më të madh të rritjeve në treg që me punën dhe menaxhimin efikas të stafit aderon që të kryesojë tregun e sigurimeve.



3.1.2. Albsig, Organizon Festën e Funvitit

Tradita vazhdon. Jemi koherent ndaj risive në treg. Por nuk harrojmë se punonjësit janë vlera më e madhe për një shoqëri. Kohën më të madhe cdonjëri prej nesh e kalon më shumë në punë (kompani), se sa në familje.

Kur të gjithë punojmë me profesionalizëm dhe trasmentojmë energji pozitive puna bëhet edhe më mirë dhe si rrjedhim shoqëria ka gjithmonë sukses.

Shoqëria e Sigurimeve Albsig Sh.a. pjesë e Kastrati Group, suksesin e saj ia dedikon gjithmonë punonjësve. Përvec punës së përditshme shoqëria Albsig Sh.a. organizon festa, evente të rëndësishme brenda dhe jashtë shoqërie. Një ndër eventet e përvitshme e cila është bërë traditë e shoqërisë, është dhe festa e fundvitit. Fundi vitit 2021 ishte një ristartim për të gjithë eventet e shoqërisë pas një shkëputje të bërë nga efekti i pandemisë dhe i dy tërmeteëve të vitit 2019.

Festa e fundvitit konkretizoi të gjithë angazhimin e punës për vitin dhe jo vetëm kaq por në saj të kësaj feste u nxorën në pah dhe u përzgjedhën punonjësit më të mirë të vitit.

Kjo përzgjedhje e bërë është përkthyer si një stimul i madh për punonjësit. Tradita është ripërtërirë ndër vite për të stimuluar sadopak punonjësit dhe për ti bërë ata të ndihen sa më mirë në ambientet ku punojnë.

Festa e këtij viti u organizua me detaje me qëllime të caktuara si: argëtues, edukativ, promovues për punonjësit e më gjerë.



3.2. Përgjegjësia Sociale e Shoqërisë Albsig sh.a.

3.2.1. Albsig Kontribues për Një Mjedis të Pastër, Mbjellja e Pemëve në Tiranë

Zgjedhim të ecim bashkë, me vlerat që na bashkojnë, duke u bërë bashkëudhëtarë të jetës tuaj, në të gjitha drejtimet!

Albsig kontribuon në mbjelljen e pemëve në zonën e Liqenit Artificial, nismë kjo, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, duke kontribuar sado pak në cilësinë e shëndetit të gjithsecilit prej nesh!



Nismës së ndërmarrë i është bashkëngjitur stafi i Albsig sh.a. i përfaqësuar nga dy zv./drejtorët e Përgjithshëm të Shoqërisë si dhe Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë Albsig Jetë dhe Drejtori i Përgjithshëm i Albsig Invest. Albsig sh.a. ka ndërmarrë një sërë nismash në ndihmë të komunitetit.

Prej vitesh në treg, kemi vërtetuar se jemi partneri që ecën krah jush, për ta bërë jetën tuaj një vend më të sigurt e të qetë, përmes gamës së shërbimeve që ofrojmë.

E megjithatë, donim të shkonim përtej kësaj.

Jo vetëm jetën, pronën, njerëzit, por kishim si qëllim të bëheshim nismëtarë në sigurimin e një pjese të mushkërisë së qytetit, e si rrjedhojë edhe të shëndetit të çdo qytetari të Tiranës. Të lumtur, që mund të bëhemi shembull që qyteti të mund të marrë frymë lirisht, pak më shumë çdo ditë.



3.2.2. Albsig në Ndihmë të Fëmijëve me Aftësi Ndryshe



“Together is better” kështu është titulluar nisma e ndërmarrë nga Eipass Albania mbështetur nga Albsig sh.a. dhe një grup biznesesh në ndihmë të fëmijëve me aftësi ndryshe!

Nisma e ndërmarrë në ndihmë të këtij target grupi fëmijësh është ndarë në disa aktivitete dhe ka përmbushur nevojat e duhura për këtë kategori fëmijësh dhe persona të rritur.

“Ndihmesën që mund të japim së bashku si dhe mesazhet e forta të

të qenurit një zë i vetëm, për të gjithë fëmijët dhe personat me aftësi ndryshe.

Kjo fushatë është vazhdimësi dhe pjesë integrale e ndërhyrjes humanitare që Albsig realizon gjatë gjithë vitit për të gjitha kategoritë në vështirësi ekonomike dhe sociale.

Aktivitetet bëjnë së bashku të rinj vullnetarë, institucionet shtetërore, shoqërinë civile, bankat, ambasadat dhe bizneset për një kauzë të vetme:”

Ndihmesën që mund të japim së bashku si dhe mesazhet e forta të të qenurit një zë i vetëm, për të gjithë fëmijët dhe personat me aftësi ndryshe!

Vetëm kështu mund të jemi pjesë e zgjidhjes dhe jo vetëm e problemit.

Faleminderit dhe përfundim për të gjithë ju që keni qenë, jeni dhe do të jeni mbështetje dhe pjesë e pandarë e kësaj nisme sa të bukur aq edhe shpirtërore!

“Së bashku më të fortë se kurrë” përmbyll fjalën e saj drejtoresha Eipass Albania Anila Busho.

Vlen për të kujtuar që është vit i dytë radhazi që Albsig mbështet Eipass Albanina në nismat e ndërmarrë. Vitin e kaluar Albsig financoi blerjen e veglave muzikore për fëmijët me aftësi ndryshe por që spikasin në fushën e muzikës.



3.2.3. Albsig Mbështet Edicionin e 12-të Shkodra Jazz Festival

“Andrra vazhdon” ky ka qenë dhe mesazhi i vitit për Shoqatën Kulturore “Rrok Jakaj” në Shkodër. Me këtë mesazh ka mundur të mbledh sërish në qytet të gjithë artëdashësit e muzikës jazz. Këtë aktivitet të rëndësishëm jo vetëm për organizatorët e eventit por dhe për qytetin e Shkodrës është kthyer në një traditë disa vjeçare, mbështetur nga Shoqëria e Sigurimeve Albsig.

Është edicioni i 12 që Shoqata Kulturore “Rrok Jakaj” mbështetur nga shumë biznese ku ndër to spikat dhe Albsig si shoqëria e sigurimeve që realizon ëndrrat e çdo artisti. “Prej disa vitesh Albsig është mbështetëse e ëndrrës tonë. Dhe ne pa mbështetjen e partnereve financiare do ta kishim të vështirë realizimin e “Shkodra Jazz Festival”, u shprehën drejtuesit e Shoqatës “Rrok Jakaj” në Shkodër.

Gjatë muajit Gusht u zhvillua edicioni i 12-të i “Shkodra Jazz Festival”. Koncerti përfundimtar i këtij edicioni “Shkodra Sounds” me pjesëmarrjen e Skanderbeg Chambe, Orkestra, të drejtuar nga maestro Pacalin Pavaci vinte si një shpresë për vitin pandemik që po kalojmë.



Gjithashtu me shumë emocion u kujtua nga artistët edhe profesori i të gjithëve zoti Kujtim Alija i cili ndërroi jetë disa ditë përpara.

Në sheshin para bashkisë Shkodër mund të ndiheshin energjitë e qytetit dhe e spektatorëve duke u sinkronizuar me muzikën klasike në një simfoni që jep shpresë për qytetin e lashtë përbri kalasë së Rozafës. Pjesëmarrja e konsiderueshme, emocionet e ngjallura tek spektatorët dhe duartrokitjet e vazhdueshme ishin përgjigja e duhur për organizatorët. Ky aktivitet po mbush ndër vite një vakum të krijuar në Shkodrën e lodhur nga varfëria dhe pandemia. Vetëm intelektualë e artistët konfirmojnë nëpër botë dashurinë për vendin dhe bashkëqytetarët e tyre.

Ata munden të bëjnë sakrifica edhe në një periudhë të gjatë e të vështirë pandemie. Interesi li tyre i vetëm me shpirtin e ndjeshëm të artistit është të rinisin një art cilësor në qytetin e tyre të përgjumuar e të lodhur nga pandemia dhe në të njëjtën kohë duke u përkushtuar në rritjen dhe masivizimin e kësaj energjie të shpërndarë në mbarë qytetin.

“Në rrugëtimin tonë të suksesshëm edhe pse pandemia na penalizoi pak, Shoqëria Albsig sh.a. ka qenë dhe mbetet aleati më besnik ku pa mbështetjen e këtij biznesi ne s’do mund ta bënim realitet ëndrrën tonë. Dhe jo vetëm kaq, por Albsig sh.a. është mbështetësja kryesore e artit e kulturës jo vetëm në qytetin e Shkodrës po kudo” - përfundon falenderimin drejtuesi i Shoqatës “Rrok Jakaj”.

3.2.4. Albsig, Mbështet Fëmijët e Policëve të Rënë në Krye të Detyrës

Tradita e përvitshme vazhdon. Me rastin e festave të fundvitit Policia e Shtetit ka kujtuar fëmijët e punonjësve të policisë, të rënë në krye të detyrës, ndërsa i ka gëzuar ata me dhurata me rastin e festave të fundvitit.

Si mbështetëse e nismës së tillë humanitare ishte dhe shoqëria Albsig.sh.a. pjesë e Kastrati Group.

Nën atmosferën festive të krijuar u bë dhe shpërndarja e pakove me dhurata të ofruara nga shoqëria Albsig sh.a. dhe organizata për familjarët dhe fëmijët e policëve të rënë në krye të detyrës.



Po ashtu për 26 fëmijë të policëve të vrarë të moshave 1 deri në 18 vjec, u tregua kujdes për 4 fëmijë me problem shëndetësorë të moshës mbi 18-vjec si dhe u erdhëm në ndihmë rreth 228 familjeve të punonjësve të policëve të vrarë ku për fëmijët u shpërndanë pajisje elektronike si ipad, telefona dhe PC.

Në eventin e organizuar nga Drejtoria e Policisë së Shtetit mbështetur nga një grup biznesesh ku ndër to ishte shoqëria Albsig sh.a. fëmijët dhe familjarët arritën të përjetonin sadopak caste gëzimi gjatë eventit dhe me pas u ndanë dhuratat dhe bonuset për familjarët.

Gjatë fjalës përshëndetëse ne event, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Gledis Nano ka uruar fëmijët dhe familjarët e Dëshmorëve të Policisë, për një vit sa të më mbarë dhe i ka inkurajuar ata që të mos stepen nga vështirësitë, pasi përherë do të kenë përkrahjen e Ministrisë së Brendshme, të qeverisë shqiptare dhe derën e hapur të Policisë së Shtetit, në çdo kohë. Drejtor Nano ka biseduar me fëmijët dhe familjarët e Dëshmorëve të Policisë, duke shkëmbyer mesazhe mbështetjeje e solidariteti, dhe u ka premtuar se përherë do gjendet pranë tyre.

3.2.5. Albsig sh.a. Mbështet Studentët Ekselent të Qytetit të Bulqizës

Shoqëria e Sigurimeve Albsig sh.a. pjesë e Kastrati Group ka dhënë mbështetje për arsimin, artin kulturën, institucionet publike, shtresat në nevojë, duke financuar dhjetëra aktivitete që janë zhvilluar.

Ajo ka vazhduar traditën e saj duke mbështetur nxënësit ekselent të shkollave të mesme. Ka qënë një thirrje e Bashkisë së Bulqizës të cilës i është përgjigjur menjëherë shoqëria Albsig sh.a. për mbështetjen e nxënësve ekselentë me rastin e festave të fundvitit.



Me mbështetjen e menjëhershme të Albsig sh.a. Bashkia Bulqizë me rastin e festave të fundvitit ka zhvilluar një aktivitet artistik përmes së cilit ka vlerësuar 208 nxënësit më të mirë nga të gjitha shkollat që ndodhen në territorin e saj. "Janë 208 nxënës nga 8 njësitë administrative me rezultate ekselente për vitin 2021, të cilët u pajisën me certifikata vlerësimi" tregojnë përfaqesuesit e Bashkisë së Bulqizës.

Aktiviteti u pasurua edhe nga programi festiv i përgatitur nga QKF, ku talentët bulqizakë performuan përmes recitimeve, këngëve dhe valleve tradicionale. Në fjalën e tij përshëndetëse, Kryetari i Bashkisë i vlerësoi më të mirët e vitit 2021 si një burim shpresë për të ardhmen e Bulqizës. "Ju sot morët vetëm një certifikatë, e cila mund të jetë një nga shumë sukseset tuaja në jetë".

"Pa padyshim ajo do të jetë një kujtim, që çdo herë do t'u sjellë në mendje vendlindjen tuaj dhe rikthimin këtu për të punuar e investuar si profesionistë e sipërmarrës në fusha të ndryshme", u shpreh ndër të tjera Kryetari i Bashkisë.

Bashkia Bulqizë nuk la pa falenderuar gjithashtu shoqërinë e sigurimeve Albsig sh.a. si partnere në organizimin e këtij aktiviteti dhe shumë aktiviteteve të tjera në ndihmë të fëmijëve.

Bashkia Bulqizë cilëson se kjo mbështetje financiar është një akt modest nga Shoqëria e Sigurimeve Albsig sh.a. sepse përcjell mesazhin që i vlerësojmë të gjithë nxënësit të cilët kanë rezultate të shkëlqyera, ata të cilët japin kontribut më shumë, fituesit e olimpiadave në rang kombëtar dhe këtë do ta vazhdojmë ta bëjmë edhe në vitet e tjera, duke ju mbështetur fuqimisht, sepse ne besojmë tek e ardhmja, besojmë se ju jeni një brez i cili do ta çojë përpara qytetin.

4. POLITIKAT E MONITORIMIT, ADMINISTRIMIT DHE KONTROLLIT TË RISKUT TË SHOQËRISË

4.1. Hyrje

Kategoria dominuese e riskut në sigurime është risku i marrjes në sigurim. Ky është risku që lind nga pasiguritë e qënësishme në lidhje me shfaqjen, shumën dhe kohën e marrjes në sigurim.

Në praktikë, risku i sigurimit mund të ndahet në: (i) risku i marrjes në sigurim ; (ii) risku i rezervimit të dëmit ; (iii) risku i kredisë; dhe (iv) rreziku i katastrofës.

Risku i marrjes në sigurim – Kjo përfshin riskun që një politikë të shkruhet për shumë të ulët të primit, të sigurojë mbulim të papërshtatshëm, ose që frekuenca ose ashpërsia e ngjarjeve të siguruara do të jetë më e lartë se sa pritej.

Strategjia e marrjes në sigurim miratohet nga KM për drejtuesit dhe agentët dhe të përcaktuara në planin e biznesit që miratohet çdo vit.

Miratimi i planeve të biznesit — dhe vendosjen e kërkesave për kapital të nevojshëm për t'i mbështetur këto planet — është kontrolli kryesor që Shoqëria përdor për të menaxhuar riskun e marrjes në sigurim

Kontrollet e marrjes në sigurim të agentëve dhe menaxherëve duhet të sigurojnë këtë marrje në sigurim në përputhje me strategjinë, planin e biznesit si dhe politikat e marrjes në sigurim.

Risku i rezervimit të dëmit – Risku i rezervimit lind kur rezervat e vendosura nuk janë adekuate për të përmbushur pretendimet eventuale që dalin. Niveli e pasigurisë ndryshon ndjeshëm në të gjitha linjat e biznesit, por mund të lindin nga rezervat e pamjaftueshme për të njohura apo të shkaktuara për pretendimet e

pa raportuara (IBNR). Këto mangësi mund të lindin nga proceset e rezervimit të pamjaftueshëm ose nga të pasiguria e natyrshme e ngjarjeve të sigurimit.

Risku i kredisë – Risku kryesor i kredisë të tregut është që risigurimi i blerë për të mbrojtur humbjet bruto nuk përgjigjet si pritet. Kjo mund të ndodhë sepse risiguruesi nuk është në gjendje të shlyejë detyrimet.

Risku i katastrofave – Plani i vijueshmërisë së veprimtarisë dhe përballimit të situatave të paparashikuara vlerësohen nga shoqëria Albsig sh.a. si një risk, i cili duhet administruar me shumë kujdes, nisur nga varësia ndaj sistemeve të IT. Shoqëria i jep rëndësi këtij risku, sepse në rastin e një katastrofe duhet të garantojë vazhdimësinë operacionale të saj dhe ti përgjigjet në kohë dhe shpejtësi kërkesave të klientëve për dëmshpërblim. Shoqëria e ka në objektivin e saj për përmisime cilësore të mëtijshme duke e rishikuar planin e vazhdimësisë së aktivitetit çdo vit.

E rëndësishme është për të qënë në monitorim të qëndrueshëm për të gjitha fushat e riskut.

Për këtë shoqëria është gjithmonë fokusuar në ndërmarrjen e masave për eliminimin apo pakësimin e riskut në nivelin e pranueshëm.



4.2. Përgjegjësitë në Kuadrin e Menaxhimit të Riskut

Menaxhimi ka përgjegjësi parësore për të ndihmuar në proceset duke identifikuar, vlerësuar dhe zbutur rrisqet materiale ndaj objektivave të Albsig sh.a.

- Duke përfshirë, por pa u kufizuar në riskun e sigurimit, riskun e investimit, riskun e kredisë, riskun e likuiditetit, risqet operacionale, risku rregullator, strategjik dhe risqet e shfaqura.
- Rishikon raportet e menaxhimit në lidhje me mbikëqyrjen e ndonjë risku, në kufijtë dhe përshtatshmërinë e veprimit të propozuar. Kjo përfshin Raportin Vjetor të Riskut, Vlerësimi i Riskut dhe menaxhimi i tij (ORSA).
- Aftësisë Paguese dhe Vetë-Vlerësimi i Riskut dhe Kontrollit (RCSA) – rishikon vlerësimin e menaxhimit për ato të reja dhe strategji në lidhje me risqet.
- duke përfshirë ndryshimin e klimës rishikon, të paktën çdo vit, oreksin dhe riskun kufizon dhe bën rekomandime për përshtatshmërinë e tyre.



4.3. Menaxhimi i Riskut dhe ORSA



Menaxhimi i riskut dhe ORSA merr në konsideratë profilin aktual dhe të ardhshëm të riskut.

Duke shqyrtuar dhe bërë rekomandime Këshillit Mbikëqyrës për përshtatshmërinë e dizajnit dhe metodologjive të lidhura me Modelin e Brendshëm të Albsig, duke përfshirë ndryshimet e modelit, testimin e stres-testeve dhe skenareve si dhe rezultatet e marra, duke bërë rekomandimet Këshillit Mbikëqyrës lidhur me Kërkesat rregullatore dhe ekonomike të Albsig për kapitalin, rishikimin e propozimeve të menaxhimit për kuadrin e riskut, politikat dhe kontrollin e brendshëm dhe bën rekomandime për miratimin ose ndryshimin apo rishikimin.

4.4. Menaxhimi i Riskut dhe Politikat e Pajtueshmërisë

Raportet tremujore të ORSA nga menaxhimi, i cili përfshinte monitorimi kundër riskut të oreksit, përditësimet e rritura të riskut, risqet strategjike dhe ato në zhvillim, vetëvlerësimi i riskut dhe kontrollet.

Kontrolli i brendshëm, sistemi i kontrollit të brendshëm ofron bazën për sigurinë dhe funksionimin e shëndoshë të biznesit, duke siguruar përputhje përkatëse me ligjet dhe rregulloret dhe ruajtjen e aseteve. Sistemi është projektuar për të reduktuar në vend e eliminuar riskun e dështimit për arritjen e objektivave të shoqërisë.

Në qëndër të sistemit të kontrollit të brendshëm janë modeli i "tre linjave të mbrojtjes". Çdo person në Shoqëri është pjesë e "tre linjave të mbrojtjes", e cila mbron Shoqërinë dhe punonjësit e saj.

Linja e parë — Funksionet e biznesit të linjës së parë: përgjegjës për funksionimin e biznesit, duke zotëruar riskun e kryerjes përgjegjësitë në mënyrë korrekte dhe për vendosjen, monitorimin dhe mbajtjen e kontrolleve të brendshme efektive brenda zonave të tyre të përgjegjësisë, si dhe respektimi i kontrolleve të forta e të gjera siç përcaktohet në politikat dhe procedurat e korporatës.

Linja e dytë — Menaxhimi i riskut, krimi financiar dhe Pajtueshmëria: funksione të specializuara dhe të pavarura përgjegjëse për mbikëqyrje, sigurimin e kryerjes së biznesit në mënyrë korrekte dhe operimi i një kuadri që siguron identifikimin e risqeve, vlerësuar dhe menaxhuar në mënyrë adekuate në përputhje me Korporatën edhe risku i oreksit.

Linja e tretë — Auditimi i Brendshëm: një funksion i pavarur sigurie përgjegjës për rishikimin se biznesi është zhvilluar në përputhje me proceset dhe kontrollet përkatëse.

4.5. Përmbushja e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut

Menaxhimi i riskut është një balancim i një numri elementesh të ndërthurur të cilët ndërveprojnë me njëri tjetrin dhe të cilët kërkojnë që menaxhimi i riskut të jetë efektiv, duke qënë në ekuilibër me njëri tjetrin. Për më tepër, risqe të veçanta nuk mund të adresohen/trajtohen të izoluar nga njëri-tjetri, menaxhimi i një risku mund të ketë impakt mbi një risk tjetër apo dhe veprimet e menaxhimit të cilat kanë efekt në kontrollin e më shumë se një risku të vetëm duke bërë të vështirë të jenë njëkohësisht dhe të arritshëm. Standardi përcakton tiparet e një sistemi efektiv të menaxhimit të riskut në nivel të lartë. Kërkesat e mëtejshme dhe udhëzime në lidhje me këto janë të mbuluara në seksione të tjera të standardeve dhe udhëzimeve të përcaktuara më poshtë:

SUBJEKTI	REFERENCA NË STANDARDE/UDHËZIME
Strategjia e riskut	SR (Plani i Menaxhimit të Riskut)
Struktura qeverisëse e riskut	SQ (Departamenti i Riskut dhe IT)
Proceset e marrjes së vendimeve	PV
Vetëvlerësimi i identifikimit të riskut	VIR ORSA
Raportimi i riskut	RR
Plani i vijueshmërisë së veprimit	PVV

Tabela 1: Kërkesat dhe udhëzimet lidhur me riskun

4.5.1. Identifikimi dhe Kategorizimi i Risqeve

Identifikimi i fushave të riskut, vlerësimi i riskut dhe më tej eliminimi, apo reduktimi i riskut në një nivel të pranueshëm duke kufizuar kostot financiare në minimumin e domosdoshëm. Menaxhimi i riskut lidhet me risqet dhe mundësitë që ndikojnë në krijimin e vlerave ose ruajtjen e vlerave të përcaktuar si më poshtë: Në Planin e menaxhimit të riskut identifikimi i risqeve është komponenti kryesor dhe ka për qëllim identifikim e të gjitha risqeve të rëndësishme me të cilat përballlet shoqëria.


4.5.2. Vlerësimi i Risqeve

Kjo fazë përfshin kuptueshmërinë e risqeve të identifikuara në fazën e mësipërme. Risqet e identifikuara do të vlerësohen në lidhje me: Mundësinë e ndodhjes së një ngjarjeje të padëshiruar kur nuk ka aktivitete kontrolli ose kur ato janë të pamjaftueshme për të parandaluar apo ulur riskun; Pasojën që një ngjarje e padëshiruar do të kishte në shoqëri nëse do të ndodhte.

Pasojë mund të jetë një lloj dëmi që shkaktohet ose mundësi që nuk shfrytëzohet (i cili mund të jetë sasiore ose i përshkruar në terma specifik). Ky proces zhvillohet në bashkëpunim me punonjësit përgjegjës të proceseve që janë vlerësuar gjithashtu. Për qëllime të kësaj metodologjie, peshash specifike janë konsideruar si në tabelën e mëposhtme:

NR.	KATEGORITË/FAKTORËT E RISKUT	PESHA SPECIFIKE PËR ÇDO FAKTOR
1	Reputacioni (R)	30%
2	Përputhshmëria (P)	30%
3	Operacionali (O)	20%
4	Financiar (F)	20%

Tabela 2: Faktorët dhe pesha specifike në vlerësimin e riskut



4.6. Kornizimi i Riskut i Shoqërisë Albsig sh.a.

Shoqëria Albsig sh.a. fokusohet tek risqet kryesore, të cilat pengojnë arritjen e objektivave strategjike. Këto risqe janë pjesë e procesit të administrimit të riskut.

Pjesë e procesit të administrimit të riskut janë dhe risqet që lidhen me veprimtarinë e përditshme. Shoqëria ka identifikuar si risqe kryesore ku dhe ka orientuar skenarët e stresit si: Risku i Sigurimit, Risku i Kreditit, Risku i Tregut, Risku i Likuiditetit, Risku Operacional, Risku Strategjik. Këto janë risqet kryesore që mund të kërcënojnë objektivat strategjike të shoqërisë, por ka dhe risqe të tjera si: Risku i këmbimit të monedhës së huaj, Risku reputacional, Risku i cmimeve të sigurimit të detyrueshëm motorik, në veçanti TPL. Risqet e pranishme në shoqëri janë të përfshira në një prej kategorive të identifikuara më poshtë:

4.6.1. Risku i Kreditit

Risku i kreditit i referohet riskut të mospagimit të detyrimeve kontraktuale të cilat rezultojnë në humbje financiare të shoqërisë. Në rrjedhën normale të aktivitetit të saj, kur pranohen primet fondet investohen për të paguar detyrimet e ardhshme ndaj të siguruarve.

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut nga fondet e mbajtura, depozitat dhe risiguruesit. Shoqëria ka vendosur procedurë të brendshme nga ku risiguruesit mund të kenë klasifikime BB ose norma më të larta dhe risku është i monitoruar nga personeli i risigurimeve. Shoqëria administron ekspozimin e saj ndaj riskut të kredisë duke monitoruar zbulimin ndaj instrumenteve të borxhit dhe depozitave.

31 dhjetor 2021	A+	A	A-	AA	AA-	AA+	BB	Pa normë	Totali
në '000 Lekë									
Aktivët Financiare									
Investimet	-	-	-	-	-	-	-	1,409,925	1,409,925
Aktive të lidhura me risigurimin	1,368	10,531	8,301	1,570	72,217	1,447	-	7,642	103,076
Llogari të arkëtueshme	-	-	-	-	-	-	-	100,325	100,325
Aktive të tjera	-	-	-	-	-	-	-	112,167	112,167
Mjete monetare në arkë dhe bankë	-	-	-	-	-	-	-	68,691	68,691
31 dhjetor 2020	A+	A	A-	AA	AA-	AA+	BB	Pa normë	Totali
në '000 Lekë									
Aktivët Financiare									
Investimet	-	-	-	-	-	-	-	1,287,370	1,287,370
Aktive të lidhura me risigurimin	13,936	41,908	68,367	404	214,132	574	-	3,884	343,205
Llogari të arkëtueshme	-	-	-	-	-	-	-	108,691	108,691
Aktive të tjera	-	-	-	-	-	-	-	72,744	72,744
Mjete monetare në arkë dhe bankë	-	-	-	-	-	-	-	60,642	60,642

Tabela 3: Ekspozimi ndaj riskut të kredisë

Informacione shpjeguese shtesë për primet e risigurimit të ceduara dhe aktivet e risigurimit sipas normës së kuotimit të risiguruesit janë si më poshtë:

	2021				2020			
	Primet e Çeduarra		Aktivet e Risigurimit		Primet e Çeduarra		Aktive të Risigurimit	
	'000 Lekë	% ndaj totalit	'000 Lekë	% ndaj totalit	'000 Lekë	% ndaj totalit	'000 Lekë	% ndaj totalit
Norma								
AA	5,909	3.9%	1,570	4.0%	70	0,1%	404	1,6%
A+	7,986	5.2%	190	0.5%	11,825	9,5%	205	0,8%
A	33,625	22.0%	9,806	25.2%	23,516	18,8%	6,291	25,7%
A-	12,873	8.4%	1,795	4.6%	18,100	14,5%	3,308	13,5%
AA-	71,855	47.1%	16,466	42.3%	57,320	45,9%	9,802	40,1%
AA+	6,714	4.4%	1,447	3.7%	2,215	1,8%	574	2,3%
AAA	1,478	1.0%	-	0.0%	1,336	1,1%	-	0,0%
Pa normë	12,068	7.9%	7,642	19.6%	10,609	8,5%	3,884	15,9%
Totali	152,508	100.0%	38,916	100.0%	124,991	100,0%	24,468	100,0%

Tabele 4: Primet e risigurimit të çeduarra dhe aktivet e risigurimit sipas normës së kuotimit të risiguruesit

4.6.2. Risku i Tregut

Risku i tregut për shoqërinë lidhet kryesisht me faktorë të tregut financiar, si normat e interesit dhe kurset e këmbimit, apo faktorë të jashtëm, si ecuria ekonomike, si dhe humbje nga portofoli i investimeve.

4.6.3. Risku i Normës së Interesit

Risku i normave të interesit është i ndikuar nga risku i luhatjeve të vlerave të instrumenteve financiare si pasojë e ndryshimeve në tregun e normave të interesit dhe risku që maturitetet e interesave në lidhje me aktivet të ndryshojë nga maturiteti i interesave të lidhura me detyrimet e përdorura për këto aktive. Kohëzgjatja për të cilën është fiksuar norma e interesit mbi një instrument financiar tregon se ndaj çfarë niveli risku të normave të interesit është ekspozuar. Aktivët dhe pasivët e shoqërisë kanë norma interesi të tregut. Shoqëria mban një shumë jo të konsiderueshme të detyrimeve interes mbartëse dhe risku i shkaktimit të kostove të rëndësishme që vijnë si shkak i rritjes në normat e interesit nuk është domethënës. Në krahun tjetër, aktivët interes mbartëse kanë normë interesi fikse.

4.6.4. Risku nga Kurset e Këmbimit

Primet janë shprehur në tre valuta kryesore (LEKË, USD dhe EURO). Flukset monetare nga të ardhurat nga primet janë burimi kryesor i fondeve për depozitat me afat në valutë të huaj. Risku i këmbimit të monedhës së huaj lind nga lëvizjet në kurset e këmbimit të monedhës së huaj. Ekspozimi ndaj këtij risku kryesisht lind gjatë një periudhe në të cilën shoqëria ka një pozicion të hapur si në bilanc dhe jashtë bilancit dhe/ose me kursin aktual ose të ardhshëm të tregut. Tabela e mëposhtme paraqet një analizë sasiore të rrezikut valutor të shoqërisë më 31 Dhjetor 2021 dhe 2020:

		2021	2020
	Ndikimi	në Lekë	në Lekë
EUR rritet me 5% ndaj Lekut	Fitim	(11,539,049)	(19,643,824)
EUR ulet me 5% ndaj Lekut	Humbje	11,539,049	19,643,824
USD rritet me 5% ndaj Lekut	Fitim	7,320,421	6,513,238
USD ulet me 5% ndaj Lekut	Humbje	(7,320,421)	(6,513,238)

Tabela 5: Risku valutor i shoqërisë më 31 Dhjetor 2021 dhe 2020

4.6.5. Risku Operacional

Risku operacional lind nga problemet në performancën e funksioneve ose proceseve të biznesit. Ekspozimi ndaj këtij risku mund të lindë nga mangësitë ose defektet në kontrollet e brendshme ose proceset, defektet në teknologji, gabimet njerëzore ose pandershmëria dhe katastrofat natyrore.

Përdorimi më efikasitet i sistemit të shitjes, administrimit dhe dëmeve ka minimizuar shumë risqe duke bërë të mundur një harmonim më të mirë midis kontrollit dhe raportimit.

Rëndësi shumë e madhe i është dhënë pagesës së dëmeve, duke e konsideruar një marketing për shoqërinë. Pagesa e dëmit në një periudhë shumë të shkurtër është një praktikë, e cila ndiqet deri në lajmërimin e klientit që vlera e dëmit të rënë dakord nga klienti ka kaluar në llogarinë e tyre dhe ka ndikuar në performancën e shoqërisë.

Analizat aktuariale ndikojnë në aplikimin e metodave më të mira aktuariale për llogaritjen e provigjoneve të dëmeve (IBNR) dhe për kontrolle më të forta mbi të dhënat nga Aktuari, sidomos të dëmeve shëndetësore të TPL, të cilat kanë luhetje në vlerësime. Për këtë Departamenti i Dëmeve bashkëpunon me Departamentin Juridik dhe Departamentin e Menaxhimit të Riskut dhe IT për marrjen e informacionit të plotë dhe në kohë për të gjitha rastet e ndodhura të dëmeve për tu raportuar saktë për efekt të provigjoneve teknike të dëmeve si dhe azhurnimi i dëmeve në proces gjyqësor me vendimet e gjykatave në periudhat që raportohen dhe në zbatim të "Procedura për trajtimin e dëmeve sipas statuseve të tyre dhe rakordimi ndërmjet departamenteve përkatëse". Testimi i

provigjonimit të dëmeve është bërë nëpërmjet analizës RUN-OFF të dëmeve. Kjo analizë është bërë për dëmet e ndodhura dhe të raportuara (RBNS) në shoqëri dhe për dëmet e ndodhura dhe nuk janë të raportuara (IBNR). Teste për vlerësimin e provigjoneve të dëmeve në 31.12.2020 për sigurimin e detyrueshëm motorik TPL, Karton jeshil, Kufitare dhe Kasko janë bërë në mënyrë të vazhdueshme në periudhat në vazhdim duke marrë rezultate pozitive. Megjithatë rezultatet pozitive janë marrë për IBNR, që për rrjedhojë sjell rezultatat pozitiv të totalit.

4.6.6. Risku Ligjor dhe Rregullator

Risku ligjor dhe rregullator lidhet kryesisht me ndryshimin ligjor dhe rregullator. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut rregullator si krijimi i provigjoneve të primit të pafituar për sigurimin e detyrueshëm motorik sipas primeve të rrezikut të përcaktuar nga AMF, pavarësisht çmimeve të zbatuara nga shoqëria. Gjithashtu shoqëria duhet të ketë likuiditet për krijimin e rezervës monetare.

4.6.7. Risku Strategjik

Risku strategjik lidhet kryesisht me pozicionimin strategjik të shoqërisë në treg. Rrisqe strategjike për shoqërinë janë humbje e klientëve potencialë.

4.6.8. Risku i Risigurimit

Kufijtë për Risigurim Programi i Risigurimit 2021

Shoqëria Albsig Sh.a. ka politika të risigurimit që kanë për qëllim përcaktimin e kriterëve dhe metodikën mbi bazën e të cilave lidhen programet e marrëveshjeve të risigurimit në mënyrë që aktiviteti sigures i shoqërisë të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të biznesit nga rrisqe të ndryshme, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Shoqëria Albsig Sh.a risiguron të gjitha rrisqet apo pjesë të përgjegjësive që ka kontraktuar me të siguruarit që tejkalojnë mbulimin maksimal të shoqërisë, të masës 10% të Aftësisë Paguese të shoqërisë Albsig Sh.a. Në lidhjen e kontratave të risigurimit, shoqëria shfrytëzon kapacitetin e konsiderueshëm teknik dhe financiar. Mbajtja e shoqërisë për cdo rrezik është brenda limiteve të përcaktuara sipas ligjit dhe rregulloreve në fuqi, ndërsa risiguruesit përzgjidhen nga tregu Europian dhe Botëror i risigurimeve, ku përfshihen: Hannover Re, Scor Re, Polish Re, etj.

Shoqëria Albsig sh.a gjatë vitit 2021 për të gjitha produktet që nuk janë të përfshira në marrëveshjet e risigurimit ekzistuese për cdo mbajtje mbi 10 % të Aftësisë paguese ka operuar me marrëveshje fakultative.

Kontratat e Risigurimit 2021, Prona, BI dhe Rreziqet e Tjera 2021

Kontrata e risigurimit të Pronës dhe Kaskos 2020, që filloj 01.04.2020 — 31.03.2021 është sërish nëpërmjet AON, duke patur në konsideratë strategjinë tonë për rritje të portofolit të pronës, konkurrencën e lartë në këtë grup produktesh, si dhe kërkesat në rritje të klientëve për një gamë produktesh të lidhura me pronën dhe aktivitetin më të zgjeruar në mbulime. Kontrata e rinovuar 01.04.2021 — 31.03.2022 na jep përparësi në trajtime në rast dëmi risigurues me emër të madh që na ndihmon në marketingun e shoqërisë ALBSIG sidomos me klientë të mëdhenj ndërkombëtarë.

4.7. Aktive në Mbulim të Provigjoneve Teknike

Në përputhje me nenin nr. 97 të ligjit 52 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" si dhe rregullores nr. 19 "Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe llojet e investimeve të lejuara të këtyre aktiveve" aktivet në mbulim të rezervës teknike llogaritet si në tabelën e mëposhtme. Gjithashtu në përputhje me Vendimin e Qeverisë nr. 96 datë 03 Gusht 2008 ndryshuar me vendimin nr. 5 datë 7 Janar 2009; shoqëritë e sigurimit nuk mund të investojnë më shumë në aktive dhe në rezerva teknike dhe matematikore se përqindjet si më poshtë.

Aktivët që mbulojnë rezervën teknike për periudhën e fund vitit 31 Dhjetor 2021:

Nr.	Emërtimi	% e Lejuar	Vlera në Fakt
I.	Aktivët e lejuara në mbulim të provigjoneve teknike. të ndryshme nga ato matematike. sipas nenit 97 të Ligjit 52/14		1,930,325,298
I.1	a) Tituj të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose Banka e Shqipërisë	100%	
I.2	b) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi. të garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë	100%	
I.3	c) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi. të emetuar nga qeverisja vendore e Republikës së Shqipërisë;	10%	
I.4	ç) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi. të shoqëruara nga garanci të emetuara nga qeverisja vendore e Republikës së Shqipërisë;		
I.5	d) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi. të tregtuar në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë;	35%	100,000,000
I.6	dh) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi. të cilët nuk tregtohen në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë. nëse emetuesi i tyre është person juridik. me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë;	5%	
I.7	e) Aksione të tregtuara në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë;	25%	
I.8	ë) Aksione. të cilat nuk tregtohen në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë. nëse emetuesi i tyre është person juridik. me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë;	5%	
I.9	f) Kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;	40%	
I.10	g) Hua të pasiguruara dhe hua të siguruara nga garanci hipotekore. garanci bankare ose siguruese në Republikën e Shqipërisë. me kusht që këto të fundit të mos jenë siguruar nga shoqëri sigurimi apo banka të kontrolluara nga i njëjti grup që kontrollon dhe shoqërinë ;	10%	55,917,691
I.11	gj) Toka. ndërtesa dhe të drejta në pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë nëse plotësohen njëkohësisht kërkesat sipas nenit 97. germa gj) e Ligjit 52/14:	30%	846,614,558
	Qëllime shfrytëzimi		
	Qëllime investimi		
I.12	h) Depozita në banka dhe/ose degë të bankave të huaja. me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë.	100%	927,793,049

II.	Investime të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike. të ndryshme nga ato matematike. për të cilat është marrë miratimi paraprak i Autoritetit:		
II.1	a) Obligacione afatgjata dhe tituj borxhi afatgjatë të emetuar nga një vend anëtar ose vend anëtar i OECD-së; që janë të klasifikuar si BBB+ e më lart sipas Standart & Poor's ose vlerësimi ekuivalent nga vlerësues të tjerë ndërkombëtarë të njohur gjerësisht;	15%	
II.2	b) Obligacione afatgjata dhe tituj afatgjatë të emetuar nga një entitet joqeveritar i një vendi anëtar ose vendi anëtar të OECD-së; me kushtin që entitetet jo qeveritare emetuese të jenë Banka Ndërkombëtare e Pagesave (BIS). Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Komisioni Evropian apo banka zhvillimi shumëpalëshe. nëse ato plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme:		
	i) Për këta tituj ekzistojnë tregje aktive të marrëveshjeve të riblerjes;		
	ii) Titujt nuk janë emetuar nga bankat apo institucione të tjera financiare.		
II.3	Aksione të emetuara nga një shoqëri aksionare e huaj. e cila tregon në tregje të rregulluara të kapitalit në një vend anëtar ose vend anëtar të OECD-së;	15%	
II.4	Kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive. të cilat tregtohen në një vend anëtar ose vend anëtar të OECD-së.		
III.	Investime të tjera të lejuara sipas Rregullores nr. 19. date 28.04.2015. neni 4:		920,918,413
III.1	b) Kredi individuale hipotekore për apartamente banimi vetëm për punonjësit e shoqërisë së sigurimit;	1%	
III.2	c) Para dhe ekuivalentë të saj (të cilat përfaqësojnë mjete monetare në arkë. mjete monetare në bankë dhe depozita me afat maturimi më të vogël se 3 muaj). në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë. me seli në Republikën e Shqipërisë;	3%	68,691,416
III.3	ç) Të arkëtueshmet nga risiguruesit. që nuk janë pezull më shumë se 90 ditë nga lindja e detyrimit;	25%	
III.4	d) Pjesën e risiguruesit në provigjonet teknike. kur risiguruesit janë të klasifikuar si BBB- e më poshtë nga Standart & Poor;		
III.5	d) Pjesën e risiguruesit në provigjonet teknike. kur risiguruesit janë të klasifikuar si BBB- e më lart nga Standart & Poor;	100%	103,076,076
III.6	e) Depozita në shoqëri ceduese dhe borxhe të zotëruara nga ato;	20%	
III.7	f) Shuma. që detyrohen nga policëmbajtësit dhe ndërmjetësit. e që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimeve të drejtpërdrejta dhe risigurorese. n.q.s nga dita e detyrimit të pagesës nuk kanë kaluar më shumë se 90 ditë. por jo më shumë se 20 % e provigjionit të primit të pafitur;	20%	242,492,369
III.8	g) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara. përveç atyre të parashikuara në shkronjën "gj". pika 1. të nenit 97. të ligjit nr. 52. datë 22.05.2014. "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".	5%	141,102,426
III.9	h) Interesa dhe qera të maturuara dhe të ardhura të tjera të maturuara.	5%	12,131,735
III.10	i) Investimet në depozitat e garancisë së Kartonit jeshil pranë BSHS	100%	40,124,020
III.11	j) Shpenzimet e marrjes në sigurim të shtyra	15%	313,300,371
IV	TOTALI I INVESTIMEVE (I+II+III)		2,851,243,711
V	TOTALI I INVESTIMEVE TE LEJUARA (Totali i "Vlera në fakt" zbritur "Investime mbi limitet e lejuara")		2,851,243,711

VI	C. Provigjone teknike. të ndryshme nga ato matematike. bruto (VI.1 deri VI.5)		2,822,048,526
VI.1	Provigjone të primit të pafituar		2,088,669,138
VI.2	Provigjone të dëmeve		733,379,388
VI.3	Provigjone për bonuse dhe rabate		
VI.4	Provigjone barazimi dhe katastrofe		
VI.5	Provigjone të tjera teknike		
VII	Tepricë (+) / Mungesë(-) (V-VI)		29,195,185
VIII	Mbulimi në % (V/VI)		101.03%

Tabela 6: Aktive në mbulim të provigjoneve teknike

4.8. Marzhi i Aftësisë Paguese

Sipas vendimit nr. 191 datë 25.03.2005 "Për miratimin e metodikës: Për mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e jetës dhe jo-jetës të shoqërive të sigurimit. si dhe elementët që e përbejnë atë" koeficienti i pasigurisë për llogaritjen e të ardhurave është vlera maksimale e pritshme e diferencës midis rrezikut aktual dhe rrezikut të marrë në konsideratë në llogaritje.

b_1 = koeficienti i pasigurisë - duke marrë në konsideratë shumën "a" është 0.18

b_2 = koeficienti i pasigurisë - i llogaritur duke marrë në konsideratë " a_2 " është 0.16

Sipas nenit 80 të ligjit 52 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" niveli i kërkuar i Aftësisë Paguese të Shoqërisë së Sigurimit është vlera më e lartë midis Fondit të Garancisë (370.000.000 Lekë) dhe 150 përqind të kufirit minimal të aftësisë paguese. Niveli aktual i aftësisë paguese më 31 Dhjetor 2021 është brenda limiteve të kërkuara.



Niveli i kërkuar i aftësisë paguese llogaritur nga Shoqëria si dhe aftësia paguese e saj është si më poshtë:

	Kufiri minimal i Aftësisë paguese. Jo Jete	31.12.2021
1	1.Llogaritja me baze primet	
2	Prime te shkruara nga aktiviteti i sigurimeve	3,328,073,892
3	Prime te shkruara nga aktiviteti i risigurimeve	-
4	Taksa te zbritshme	83,411,998
5	Shuma "a" (5=2+3-4)	3,244,661,894
6	Pjesa e shumes "a" me e vogel se 1.000.000.000 leke (6=min(1.000.000.000.5))	1,000,000,000
7	Pjesa e shumes "a" me e madhe se 1.000.000.000 leke (7=5-6)	2,244,661,894
8	Koeficienti i pasigurise a1 (8=0.18)	0.18
9	Koeficienti i pasigurise a2 (9=0.16)	0.16
10	Total (10=6*8+7*9)	539,145,903
11	Deme te paguara bruto	873,105,465
12	Pjesa e risiguruesit ne demet e paguara	171,732,403
13	Deme te paguara neto (13=11-12)	701,373,062
14	provigjone bruto te demeve ne periudhen aktuale	733,379,388
15	provigjone bruto te demeve ne fund te vitit te kaluar	1,026,815,831
16	pjesa e risiguruesve ne provigjonet e demeve ne periudhen aktuale	64,159,872
17	pjesa e risiguruesve ne provigjonet e demeve ne fund te vitit te kaluar	318,735,591
18	provigjone neto te demeve ne periudhen aktuale (18=14-16)	669,219,516
19	provigjone neto te demeve ne fund te vitit te kaluar (19=15-17)	708,080,240
20	ndryshimi ne provigjonet e demeve bruto (20=14-15)	-293,436,443
21	ndryshimi ne provigjonet neto te demeve (21=18-19)	-38,860,724
22	Deme te ndodhura bruto	579,669,022
23	Pjesa e risiguruesit ne demet e paguara	662,512,338
24	Deme te paguara neto (13=11-12)	1.1429
25	Rezultati nga llogaritja me baze primet (25=24*10)	616,189,853

Tabela 7: Niveli i kërkuar i aftësisë paguese llogaritur nga Shoqëria si dhe aftësia paguese e saj



Marzhi i aftësisë paguese duke përdorur metodën e kapitalit neto më 31 Dhjetor 2021 përbëhet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	31 dhjetor 2021
I	Kapitali bazë. Neni 76 i Ligjit 52/14 (I.a+I.b+I.c-II)	1,826,136,560
I.a	Kapitali aksionar i shoqërisë së sigurimit. i cili përbëhet nga aksionet e zakonshme të emetuara;	879,460,000
I.b	Rezervat e kapitalit. të cilat nuk i korrespondojnë detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit;	-
I.c	Fitimi i pashpërndarë. i mbartur pas zbritjes së dividendëve të pagueshëm	949,938,041
II	Elementet që nuk përfshihen në llogaritjen e kapitalit bazë: (II.a+II.b+II.c+II.ç)	3,261,481
II.a	Aksionet e veta të riblera	-
II.b	Investimet në aktive të patrupëzuara	3,261,481
II.c	Humbjet e mbartura dhe humbja e vitit ushtrimor	-
II.ç	Diferenca midis provigjoneve të dëmeve të skontuara dhe të paskontuara.	-
III	Kapitali shtesë. neni 77 i Ligjit 52/14 (III.a+III.b+III.c+III.ç)	-
III.a	Kapitali aksionar i cili përbëhet nga aksionet me përparësi të akumuluar	-
III.b	Instrumente të borxhit të varur	-
III.c	Rezerva kapitali që lidhen me aksionet me përparësi të akumuluar	-
III.ç	Elemente të tjera	-
IV	Elementet e zbritshme në llogaritjen e kapitalit. neni 79 i Ligjit 52/14 (IV.a+IV.b+IV.c+V)	641,901,723
IV.a	Pjesëmarrje dhe instrumente të borxhit të varur në një tjetër shoqëri sigurimi. risigurimi. grupi kontrollues sigurimi. banka dhe/ose degë të bankave të huaja. shoqëri komisionere. shoqëri administruese dhe institucione të tjera financiare. në të cilat shoqëria e sigurimit zotëron pjesëmarrje influencuese mbi 10 për qind	432,254,000
IV.b	Investime të tjera në personat e parashikuar në shkronjën “a”. të kësaj pike. që janë përfshirë në llogaritjen e kapitalit të personave përkatës	-
IV.c	Pjesëmarrjet dhe titujt e borxhit të varur. si dhe investime të tjera në një shoqëri tjetër sigurimi ose ente financiare. të tjera nga ato të parashikuara në shkronjën “a”. të kësaj pike. të cilat kalojnë masën 10 për qind të kapitalit të shoqërisë së sigurimit. e llogaritur përpara zbritjes së elementeve të përmendura në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike	-
V	Aktivët jolikuide (V.a deri V.g)	209,647,723
V.a	Aksionet e palistuar në tregje të rregulluara	-
V.b	Huatë/llogaritë e arkëtueshme me palë të lidhura	55,917,691
V.c	Huatë nga brokerat dhe agjentët	-
V.ç	Primet e arkëtueshme ose debitorë nga risigurimi. që kanë tejkaluar afatin 90- ditor;	-
V.d	Debitorë të tjerë ose llogari të tjera të arkëtueshme. të cilat nuk rrjedhin drejtpërsëdrejti nga veprimtaria e sigurimit;	70,263,606
V.dh	Inventari	1,779,669
V.e	Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	-
V.ë	Shpenzimet e parapaguara	-
V.f	Aktivët e tjera. të cilat nuk janë të lira nga çdo përgjegjësi apo detyrim i parashikuar	-

V.g	Aktivet e tjera, të cilat nuk janë lehtësisht të kthyeshme në para në momentin kur është e nevojshme përmbushja e detyrimeve financiare kur u vjen afati	
V.h	Elementë të tjerë të zbritshëm sipas nenit 4 të kësaj rregullore (V.-h-1 deri V.h-10) :	40,124,020
V.h-1	<i>Emri i mirë i shoqërisë</i>	
V.h-2	<i>Toka, ndërtesa dhe të drejta në pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë nëse nuk plotësohen njëkohësisht kërkesat sipas nenit 4, pika 1. germa c) të rregullores</i>	7,583,447
V.h-3	<i>Aktive afatgjata materiale për të cilat shoqëria nuk zotëron dokumentacionin mbi pronësinë;</i>	
V.h-4	<i>Aktive afatgjata materiale që vijnë nga shpenzime për përmirësimin e ambienteve me qira</i>	
V.h-5	<i>Aktive afatgjata materiale në formën e materialeve publicitare</i>	
V.h-6	<i>Likuiditete në Banka, në rast se shoqëria ka një linjë kredie të hapur në llogari rrjedhëse</i>	
	<i>(overdraft) apo të ngjashme, në vlerën maksimale të kredisë së hapur në llogari rrjedhëse</i>	
	<i>(overdraft) apo të ngjashme;</i>	
V.h-7	<i>Të ardhura të llogaritura nga paditë e regresit nga Fondi i Kompensimit apo të tjera në rast</i>	
	<i>se shoqëria nuk zotëron dokumentacion justifikues të mjaftueshëm për të garantuar</i>	
	<i>arkëtimin e shumës</i>	
V.h-8	<i>Të gjitha aktivet e lëna si kolateral, të lënë peng apo që nuk janë të lira nga çdo barrë tjetër</i>	
	<i>në të gjithë vlerën e tyre</i>	
V.h-9	<i>Fondi i Garancisë për Kartanin Jeshil</i>	
V.h-10	<i>Çdo zë tjetër në kundërshtim me kërkesat ligjore, rregullore dhe vendime të Bordit të</i>	
	<i>Autoritetit</i>	
VI	KAPITALI (Aftësia Paguese)	1,184,234,837
VII	Kufiri minimal i aftësisë paguese, sipas pikës 3 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	616,189,853
VIII	Fondi i garancisë, sipas nenit 81 të Ligjit Nr. 52/2014	370,000,000
IX	Niveli i kërkuar i aftësisë paguese, sipas pikës 2 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	924,284,779
X	Mbi (+) / nën (-) nivelin e kërkuar të Aftësisë paguese (VI-IX)	259,950,058
XI	Mjaftueshmëria e kapitalit	E mjaftueshme

Tabela 8: Marzhi i aftësisë paguese duke përdorur metodën e kapitalit neto më 31 Dhjetor 2021

Shoqëria gjithmonë ka një parim se menaxhimi i riskut është një balancim i një numri elementesh të ndërthurur të cilët ndërveprojnë me njëri tjetrin dhe të cilët kërkojnë që menaxhimi i riskut të jetë efektiv, duke qënë në ekuilibër me njëri tjetrin.

Për më tepër, risqe të veçanta nuk mund të adresohen/trajtohen të izoluar nga njëri tjetri, menaxhimi i një risku mund të ketë impakt mbi një risk tjetër apo dhe veprimet e menaxhimit të cilat kanë efekt në kontrollin e më shumë se një risku të vetëm duke bërë të vështirë të jenë njëkohësisht dhe të arritshëm.

Shoqëria është e fokusuar në një raportim efektiv të informacionit kyç të riskut të qeverisjes për të siguruar që personat e përfshirë të kenë të gjithë informacionin e nevojshëm për të marrë në konsideratë në procesin e vendimmarrjes.

Një punë e vazhdueshme nga shoqëria është dhe ngritja e nivelit të ndërgjegjësimit të punonjësve në përgjithësi dhe në vecanti me çështjet që janë të lidhura me menaxhimin e riskut. Kjo realizohet me anë të seminareve, trajnimeve etj.

Planet e veprimit janë zhvilluar në mënyrë tipike dhe zbatuar për të adresuar nivele të papranueshme të riskut dhe / ose riparimin e dobësive të kontrollit.

Duhet të marrin në konsideratë se si proceset e sigurimit të mund të sigurojnë funksionimin efektiv të kontrolleve dhe zbatimin e planeve të veprimit.

Për risqet që janë cilësuar më të lartat (më kritiket), duhet të hartohet një plan afatgjatë veprimi. Nëse risku mund të ndikojë në aktivitetin e dy, ose më shumë drejtorive, ky plan duhet të miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë.

Në përfundim të këtij dokumenti është hartuar edhe plani i veprimit i përcaktuar për minimizimin e risqeve të evidentuara si prioritare.



5. AKTIVITETI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM PËR VITIN 2021

5.1. Objektivi dhe Qëllimi i Auditimit të Brendshëm

Auditimi është një aktivitet i pavarur dhe objektiv konsulence për të dhënë siguri dhe udhëhiqet nga parimi për të shtuar vlerë në përmirësimin e operacioneve të Albsig sh.a. (Shoqëria). Auditimi e ndihmon Shoqërinë në arritjen e objektivave të saj, duke nxitur një sjellje sistematike dhe të disiplinuar në vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit të qeverisjes së brendshme, manaxhimit të riskut dhe kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.


5.2. Metodologjia dhe Parimet e Auditimit të Brendshëm

Auditimi i Brendshëm ka ushtruar veprimtarinë e tij në përputhje me Kartën e Auditimit të Brendshëm, e cila përshkruan misionin, qëllimin, objektivat e punës dhe përgjegjësinë e funksionit të auditimit të brendshëm të Shoqërisë. Gjithashtu, njësia ka plotësuar kërkesat e rregullores "Për Veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në Shoqërinë e Sigurimit" miratuar me vendimin e Bordit, nr. 153, datë 23.12.2014 dhe ka ndjekur praktikën më të mira ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm, të rekomanduara nga Instituti Ndërkombëtar i Auditimit të Brendshëm. Në krijimin e Planit të Auditimit janë marrë parasysh se cilat janë proceset më të rëndësishme të aktivitetit të Shoqërisë, duke u bazuar në një analizë risku dhe duke përcaktuar prioritetet sipas rastit. Njësia e Auditimit të Brendshëm ka kryer angazhimet e planifikuara në Planin Vjetor të Auditimit të Brendshëm, të cilat i janë raportuar manaxhimit në raportet e veçanta të auditimit.

5.3. Pohimi për Pavarësinë

Aktiviteti i auditimit të brendshëm ka qënë i pandikuar nga ndërhyrje për mënyrën e organizimit, si dhe nga çdo ndërhyrje në lidhje me përcaktimin e qëllimit, procedurave, shpeshtësisë së kontrollit, apo përmbajtjen e raportit të auditimit.

Audituesi i brendshëm i Shoqërisë ka shfaqur nivel të lartë të gjykimit profesional dhe objektiv në mbledhjen, vlerësimin dhe komunikimin e informacionit mbi proceset, të cilat kanë qënë subjekt auditimi. Njëkohësisht, audituesi i brendshëm i Shoqërisë ka ushtruar një gjykim të balancuar duke shqyrtuar të gjithë rrethanat e duhura dhe nuk është influencuar nga interesi personal.



5.4. Struktura Organizative dhe Raportimi

Auditimi i Brendshëm sipas organizimit të Shoqërisë raporton tek Komiteti i Auditimit, Këshilli Mbikëqyrës dhe tek Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë. Për kualifikimin e vazhdueshëm në fushën e Auditimit të Brendshëm, personeli i departamentit është angazhuar dhe ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme trajnimi, çertifikimi dhe programe profesionale në fushën e auditimit të brendshëm. Gjithashtu, dëshirojmë të theksojmë se njësia e Auditit të Brendshëm, për vetë shërbimin që ofron jo vetëm për "Albsig" sh.a, por dhe për "Albsig Jetë" sh.a dhe "Albsig Invest" sh.a, është shtuar edhe më një punonjës plus gjatë vitit 2021. Tashmë njësia e Auditimit të Brendshëm është 1+3.

5.5. Opinioni i Audituesit të Brendshëm

Auditimi i brendshëm ka realizuar kënaqshëm aktivitetet e planifikuara në planin e auditimit të brendshëm për vitin 2021.

Si rezultat i kryerjes së aktiviteteve të auditimit të brendshëm, përveç çfarë është raportuar vazhdimisht për tematika të veçanta, nuk janë evidentuar gjetje kritike ose gabime materiale të cilat të kenë një impakt domethënës në aktivitetin e Shoqërisë. Janë dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e procedurave, administrimin e informacionit dhe dokumentave si dhe proceseve të ndryshme fokusuar në risk si dhe është monitoruar niveli i realizimit të tyre. Pas përfundimit të të gjitha etapave dhe procedurave të auditimit të brendshëm në lidhje me testin e kontrolleve të brendshme dhe mbi efektivitetin në aplikim të aktiviteteve të kontrollit, për vitin e mbyllur 2021, pavarësisht rekomandimeve të dhëna për përmirësim në aspekte të veçanta, është vërejtur një nivel i kënaqshëm i kontrolleve të brendshme.

Auditimi i Brendshëm
Suela POPA



6.1. Opinioni i Auditorit të Brendshëm



RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Drejtimin e Shoqërisë Albsig sh.a.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të Albsig sh.a. ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare bashkëlidhur janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA) që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacioni tjetër

Drejtimi është përgjegjës për informacionin tjetër. Informacioni tjetër përfshin informacionin që jepet në Raportin Vjetor, të përgatitur nga drejtimi në përputhje me Ligjin 52 "Për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve", dhe nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit mbi to. Raporti ynë mbi këto pasqyra financiare nuk mbulon informacionin tjetër dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj tjetër konkluzioni që jep siguri mbi to.

Ne lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësitë tona janë të lexojmë informacionin tjetër dhe, gjatë këtij procesi, të konsiderojmë nëse informacioni tjetër është në mënyrë materiale jo konsistent me pasqyrat financiare ose me njohuritë e përfituara gjatë auditimit ose nëse në dukje është në mënyrë materiale i gabuar.

Nëse, bazuar në punën që ne kemi kryer, ne arrijmë në përfundimin se ka gabime material në informacionin tjetër, atëherë ne duhet ta raportojmë këtë fakt. Në datën e lëshimit të këtij raporti, Shoqëria akoma nuk e ka publikuar informacionin tjetër. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në lidhje me të.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur

përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuideojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternative tjetër reale përveç sa me sipër.

Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

